

Tahir Jaha

*Mos prek në
strajcë të fukarasë*

Jeta e Re

Tahir Jaha

MOS PREK NË STRAJCË TË FUKARASË

Libri i tretë

Boton «Jeta e Re»

Prishtinë 1995

Redaktor

Ali D. Jasiqi


Recensentë

Hasan Hasani

Jonuz Fetahaj

Përkujdesja artistike

Vllaznim Jaha



Caligaris

MOS PREK NË STRAJCË TË FUKARASË

1.

Kuçedra e zezë tashmë ishte selitur në trojet arbërore, si të zënte rrënjë përgjithmonë. Zhagitej në bykun e kalesës që tragjedia të ishte më e shëmtuar. Punëtorët ditën shisnin djersën e natën bënin hesap huqet e Pandurit - pushtetmbajtësve. Një hise çëfçinjësh shndërroheshin në argatë bujqësorë, e toka rrënkonte për punë. Tregtari i vogël bëhet ortak me të mesmin - kafshatë e të mallkuarit të madh. Punëtorja bartë angarien... vegjëlja paguan haraçin.

Mohimi i fjalës dhe puna me qesim shënojnë ngecjen që u mundëson dhengrënësve të bluajnë e të gatuajnë, pa shoshë, pa sitë, si mos të kishte kush i del zot kafshatës. Lugetën e rrahagjokës lodrojnë të çfrenuar e përulen si të gjorë. Çka u vjen përdorësh e numërojnë si kapar nga cikrrimet e lojës me fat.

Qëndresa, përkonrazi përforcon ndryshimet që mëkëmbin të uriturit. Veçohet FANTAZMA - kuçedr e terbuar që ngushton rrethimin, duke thelluar vorbullin e mjerimit. Por, Baca i guximshëm ofron vë në peshojë bujarinë - ofron: bukë, kulturë dhe barot. Një buzëqeshje hirplotë, aty për aty shndërrohet në përzemërsi, ashtu në kushte e rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme ndanë dhëntinë që bart në STRAJCËN E FUKARASË... diç e veçuar si uzdajë me nafakë...

Luftëtarët e lirisë edhe kështu forcojnë pejzat e vetëdijes sociale e nacionale - bashkojnë popuj në luftë për mëvehtësinë kombëtare dhe mirëqenien njerëzore, duke dëbuar okupatorin nga trojet amtare.

- Ti, këtë kafshatë ndaje vëllazërisht; ju lexoni e shpërndani literaturën. Revolet dhe bombën përdorni vetëm në zor të shpirtit...

- Shkurt na preu! - vërejtja Patri.

- Mos ta ndërroja rrugën, më shkurt do t'ma këpusnin...

- Domethënë, "ta ndërrosh rrugën paske mësuar, kurse "Lexo e shpërndajë"... vetëm neve paskëshim hise!?

- Për sot... nuk mund të presim ndryshe... këto janë dy veprime që farkohen në një praktikë.

Më rrokën rrëngqethje, si ndërmjet ankthit e gëzimit. Mbase shtetrrëthimi nuk qas mëdyshe; ndërsa

përfillja don çiltëri e përkushtim, në mënyrë që i urituri ta ruajë dhe të fitojë aq takat sa t'i qëndrojë urisë dhe t'i dalë zot mëvehtësimit kombëtar.

Ndërkaq korrieri ngjesh gjurmët... I zoti i shtëpisë, të cilit për kafshatë i qanin carrokët ia çeli derën - shtegun miqësor, mu në muzgun e zyrtë të ditës pa diell...

Në ferk të sabahit u hap dera e Bazës pranë Bisticës. Nga strajca magjike nxjerrim ushqimin përkatëse. Por secili bluan në mënyrën e vet, ndërsa vepohet bashkarisht, si domosdo e kohës.

Lëvizja jep gjallëri - guxim. Por, vetë çka po përsias!? As nuk jam vetëm, as i vetmi që prek rradakën për secilën çështje veçmas?! Mbase çdo vegëz e ndërthurrur ka një sqarim dhe një psehe...

Patri, si mjeshtër dhe, më i përshtatshmi, pa luhatje çeli letrat me patriotin antifashist, në mënyrë që u krijua lidhja e shëndoshë, përkundër motit të brishtë. Po burrërohen djelmohat buzagaz...

U nisa me Bacën, vëllaun tim të vogël. Në brryl të rrugicës na u zgjat hija, si diç e shpifur. Ishte Pandurri që vrojtonte. Asnjëherë nuk preku krahun që barte atë strajcë të bekuar. Shpresonim se nuk do të bëhet e kobshme, mbase edhe ai i dronte sherrit...

- Sot paske dalë si pa ajam!? I zyrtë po më dukesh. - vërejti Panduri, ashtu dyshimshëm.

- As dje s'kam punuar... as sot... as për kafshatë...

- As strajca s'të bën asnjë para!

- Sikur të kisha para do të bleja... çantë lustërfini... si të Komandarit tënd... gjithë lagjes do t'i shisja salltanet dhe, pa përshëndetje...

- More, fort azgën po më paraqitesh!? As nuk po shoh me çka jeton ti!? - injoroi Panduri që ishte me emër e me punë pandur.

- Vetë jetoj me fuqinë e krahut...

- Bashkija ishte dashur të të ushqejë... aq të mungon... për punë që bën nuk e lanë barra qëranë... por ti e di...

Në kthesën e parë, krye rrugës, Baca humbi gjurmët... tfilloi me gjysmë shpirti dhe i brengosur... Shpejtoi hapat që ta shpërndante literaturën, jo si shpërblim, as të falur, veç hise e luftës për liri.

- U vonove pakëz! - përgëdheli shoku që priste lidhjen.

- Shiko në strajcë! - ofshani Baca.
- Ngusht ta paska pru Panduri!?
- Kurrë më keq! - përgjegji Baca me gjysmë fryme.
- Çka do të bëje sikur ta ngrehte nagantin në gjoks?!
- Çka tjetër, veç t'i kceja në fyt!?

Mahija ka mahinë, por dushmani ta zë frymën. Ai është dinak i madh. Madje, shumë i rrezikshëm, vërejti Patri dhe vazhdoi: "Pa marrë parasysh kohë, as rrezik, prej orës pesë të mëngjesit, çdo ditë duhet të dalish në "treg të argatëve". Por ki menden se josh kend që të merr në punë... dhe, me Pandurin më pak shibla. Sepse na dështon plani... dhe me te shkon edhe kryet! A more vesh!?"

- Paj... ta kishe kuptuar ti, si e kaloj ditën unë, me siguri do të ishim më të marrur vesh...
- Hë, ne jemi kuptuar! Betimi s'lehet peng edhe sikur të shkojë kryet! Duke kryer detyrat do të kalitemi dhe, mund të përparojmë më shpejt... do të përballojmë edhe më shumë...
- Edhe Panduri po më sillet sakt!
- Ti, me atë mos e zgjat kurrsesi... ai veç të ngreh në kokrra, e ta këput në fyt! Burrëria e atyre është dinakria... si të marrin frymë - çojnë krye... tregojnë dhëmbët.

Në hapin e parë Baca fitoi njohuri të reja dhe, aftësohej t'u fliste edhe të tjerëve. Por, qysh t'u fliste të uriturve, dhe s'kishte bukë as për veti? Ndërkaq të ngishmëve s'u merrte kryet vesh për bukë, as për kulturë, mësa për borë të parvjeme. Zingjinat e ri hanë në krye të gjarpërit; ata të Legalitetit emruan Regjentin e të shërbejnë djallit të zi. Një hise pëkrahe "Mëkëmbësin" dhe përshëndoshin allamançe... të tjerë shtyhen pa lutje, me ankesë...

Liridashësit me armë të rrëmbyera nga pushtuesi po përforcojnë frontin e çlirimit kombëtar...

- Ata që lavrojnë në dritën e zjarrit mund të mbjellin në mal e gatujnë në rrafshin ku shtrohet sofa e vëllazërisë.
- Shiko bir-o! Se, neve na mbanë edhe çka s'e shohim...

Këtë mesele të babait s'e kuptoja dot... Por, vala e jetës edhe Bacën e farkoi si hise të praktikës jetësore: e përplasi për shkëmb - nuk u thye; e rrokullisi tatpjetë lumit të rrëmbyeshëm - nuk u mbyt, as pushtuesi s'e përbiu dot...

* * *

Rrjedha e ngjarjeve të ndërthurrura me dhunë e tradhti fusin në grackat e sprovave e të vuajtjeve, si ndërmjet FESË E POLITIKËS... Feja kërkon përkushtimin e respektimit të rregullave të saj, pa marrë parasysh bindjen vetjake, kurse ndaj politikës ende kisha botëkuptime të çuditshme. Mbase ajo nis e sos ishte ushtruese mëdyshtjesh, siç thotë populli: "të birin e bën zog politikani", domethënë katërqinsh - politikaxhi, pa mend për treg, pa "ujë në sy"... dhe, vetë pa shoshitur qëndrimin i droja grepit të ndonjë politike që do të ishte si "bajë verë e pi ujë" dhe, jo prej burimit, veç nga çepi...

Liridashësit e kuptuan luftën, si mundësi për çlirimin kombëtar e social. Dhe luftuan burrisht duke mbështetur besimin e ndërsjellë, pa drojën e rrëshqitëzave theqafëse. Mbase pushtuesi ushtron dhunën që të shkatrojë qëndresën, pa lënë vend, as rend për përshëndetje të përzemërt. Nxiti urrejtje e përçarje. Por, kush rrëmben armët zgjohet dhe ecën në hap me kohën, nuk pret deri t'i njohë tërthoret - mësynë shtegun. Mbase ankthi turbullon trurin, në mënyrë që zullumi tejkalon rrathët e çmendirës.

Në rrethana të zymta, Baca përfilli punën ilegale - grushtin rrufe. Mund t'i kontrollohej Strajca dhe mos të kthehej në Bazë; pragu i rrëmihur t'i bëhet rrasë varri. Por, i grahu më të vetën. Eci e luftoi, ndërsa pushtuesi zgërdhiet pranë viktimës së masakruar. Edhe trojet tona gjithë janë bërë shesh përplasjesh të përgjakshme.

Ngritet vegjësia - nyje e pazbërthyer - qeshë fati që prodhon dritë. Dhe, ne do të sprovohemi, si ari në zjarr... se edhe në ari ka çka tretet. Vërshon Ereniku që bart gurë e dhe - vadit mbivadet dhe shton pjellshmërinë e rrafshit të truallit lavdi. Aty qypria e Kullës bëhet prej lisit më fisnik që laton sakica.

2.

Risitë ishin të befasishme. Por, dëshprimin më të dhimshëm e përjetova më një rast mizor: gjakatarin e egër, bashibuzuk në uniformë, me ndihmën e Pandurit e vrau fakirin midis pazarit, se i dudket zhelan i lirisë - "kuqoj që bërlyket ndaj karaxhës"! E la të shtrirë përtokë, pa puthjen e carrokëve të cullakosur, si picrraku në shi, ashtu të uritur... dukeshin si grumbull gurësh - ledhe të lashta...

Ëndroja njëfarë ushqimi të pashijuar... Në ankth më bëhej sikur të isha struktur në zemër të malit. Dhe, malin e prente sakica, si në përrallë: sakicën e djeg zjarri, e zjarrin e shuan uji - ujin e pinë buajtë... Ata ndrydhin bretkosatt, e ato trimërojnë lepurin që mos të mbytej në gjol... Mirëpo, rendin nuk e lejonin rrethanat...

Renditja, aty për aty, nuk më shkonte përdoresh. Anarkia nuk ka rend kurrfare... kryet ma merrte anën, si ta shtynte era dydrejtimesh, më sillej rrotull si bosht pa çekërk... Meditoja djersën e fakirëve, nga e cila një hise u shkonte për ta kthyer uhanë; një hise për tokën e punuar me qesim; çka djeg hëna, e sa rjepin korbat nuk peshohet dot - fara e kafshata mbestin veresi...

- Malli i varfanjakëve nuk firon lehtë, mbase është pak dhe i numruar - peshohet nga shumë të uritur...

- Shoqëria harxhuese mbulon qyrykun që e lustron reklama.

- Lufta për ekzistencë e bën njeriun të qëndrueshëm: fshatarit i mbinë gruri në vang të opingës, ku zën byku, pa ndërruar çorapat, pa larë këmbët; ndërsa ngjalla dliret nga maja, degët krasiten rend...

Sofra e mikëpritjes nuk do të lavdërohej sikur mos të shprehte hijeshinë e çiltërisë së shqiptarit që pret ashtu me dorë në zemër.

Përkundrazi në ethet e vrapit për pushtet, brrylaxhiu i bën varfanjakët krande për zjarrin e parillëkut që shuan apetitin me hypjen në post, në të cilin lustron dizgjinat që stolisin takëmin e kalit...

Ndërkaq Bacën e çoi rruga para "Trup-rojës", por e shtyu guximi. I priu Ora e truallit, mu pranë varrit të çelur... Pesha e ngjarjeve, shkalla e vetëdijes dhe guximi shtytës emërtohen me pleqërishten e trojeve micianiane - trim i urtë - hise e forcave që kthejnë fytyrën kah dielli, e truallit i dhurojnë dritë.

Dhe, shquhet STRAJCA E FUKARASË, të cilën nuk e kapi grepi, as s'e shitonte dot "syri i keq". Barti ç'mos: pusulla, lajme e direktiva dhe, shënime konspirative e tjera sende që shukasin dhe zhurmojnë ndrrohen dorë nëpër dorë. Por, nuk shmangej rreziku që përballë patrollës, ose para rrethimit do të digjen e shkyhen. Letrat e fshehta shpesh "përtypen si petë bakllave", bartësi i përbinte ashtu si përçapet murrizi. Se, në çastin kritik, hanxhari do t'ia nxirrte bashkë me zorrë edhe sytë.

Dita nuk premtonte muzg gazmor, e nata gdhin pa shpresë për kafshatën e gojës. Pushtuesi gjithashtu rëndon zullumin mbi të nënshtruarët. Lëkurën e të papunëve do t'ia dhurojë "industrisë" për dredhë cilësore, me të cilat qëndisen mizoritë më të shëmtueshme.

- Nuk bën ta shesim fuqinë e krahut e për pak të presim lëmoshë.

- Pushtuesve dhe shfrytëzimit mund t'u prehet nafaka me barot. - përforcoi Baca dhe zu të rendis: interesat e thurrura me pejzat e ndërgjegjes krijojnë frytin që s'e brenë teja e mëndafsht, as ndryshku i hekurt...

Toka m'u suall rrotull, si mos t'u zëja besë syve. Nuk e shoshita mirë, as nuk u pajtova me fatin edhe pse nuk dija shumë, as nuk shihja larg. Ca s'më lëshuan këmbët kur pashë shokun që po shtynte karrocën e ngarkuar me mall të pushtuesit, ashtu i veshur me uniformë të të burgosurit, me numër të zi në shpinë... i kërrusur, pa shikuar djathtas, as majtas. Ishte rraskapitur, si ta ngrehte karroca atë, e jo ai që shtynte me gjysmë shpirti dhe, me takat të fundit.

Ngjarjet, dashtë e padashtë, zhvilloheshin ashtu prapësht si merr rrungaja tatpjetën. Situata ndrron sa çel e mbyll sytë. Por, hallkat farkohen në rrathë që përthekojnë kthesat, në të cilat për një fjalë goje shkon kryet. Dhe, ka pse të shkojë... po çelet shtegu i dritës - shuhet muzgu bashkë me forcat e errta.

Prapavia përgaditet për rezistencën që do të bëhet konfrontim i armatosur. Pesha e STRAJCËS tashmë bartet edhe me mjete të motorizuara, dhe përcillet nga shumica, për në shesh të nderit, ku varfanjakëve u qesh fati, si diell me dhëmbë: i plaçkisin të shqelmuar, mandej bashkë me argatë i burgosin dhe i vrasin; të nëpërkëmburit mbesin gjallë e për gazep. Mbase gllabëruesi pret "të thehet kerri", në mënyrë që pastaj të skajojë barrën, të cilën ia falë drejt që mbledh kusuret për të pjellur sherri. Haku shkrihet si ashti në gojë të qenit; vlera e punës paguhet sa për kafshatë të gojës... shtohet hordhia e të papunëve. Zija e bënë më të zymtë pravnerën, në të cilën shtyhen brrylat e çatalluar... "Peshku i madh han të voglin". Shpërthen kriza e quajtur luftë zaptuese, në të cilën del fitues grushti i popullit që mbanë dizgjinat. Megjithatë, kur të ulet armiku në KUVEND për paqe - nxito të ia mundësh me urtësi që të zë vend pleqërishtja.

Diç përbiron veshin e shurdhër - diç e re, e pa parë, e pa njohur. Djalli pas tri pikave këput lidhjen për ta mëshehur krimin, si gjarpëri këmbët. Ndërsa varfanjakët shkëpusin viktimën nga shpirti...

Micani për ta mbrojtur nga Kaçakët e mbajtti në besë "KORBIN" e shpifur si mik i shtëpisë, i cili e tradhtoi keqas. Mciani i tradhtuar megjithatë shpërtheu rrethimin me shpirt në fyt, si i erdh përdoresh. E ngushlloi kënga e qyqes - vaji i nënave me duar në gji...

Edhe Baca barti Strajcën e Fukarasë të quajtur fortesë lëvizëse: barti pak, por ushqe një ordhi dhe i teproi. Përçon dije e urtësi, kur vetë s'kishte sa duhej; mësoi, shpërndau barot kur bezi gjindej... Dëshiroi që mos të kishte të atillë që gëzohen për fatkeqësinë e të tjerëve.

Shpresë e ngushllim merret nga "Bjeshkët e Nemuna" - bukuria madhështore e maleve Tona. Nga

"Gurrat e Bardha" rrjedh Ereniku - i kristaltë që shkumëzon si qumështi i bardhokave, të cilat mrizojnë nën hijen e "Thanës së Bardh" midis "Livadheve të Egra" përkrah Kullave me franxhi të përgjakura...

* * *

Çështjet kyçe, shikuar nga rrafshi i ndërgjegjes, zgjojnë këndshëm dhe shkrijnë ndryshkun e prapambeturisë. Por nuk fleja siç thohet: kush flenë me qen çohet me pleshta, as qoshëve ku kaplojnë mizat, "prite Zot" të më hynte në gojë ndonjë çapin që nuk del nga barku pa qitë zorrët në ledinë...

Nata ngadalësonte agun. Në atë terr kotesha pa zgjidhë nyjen, pa shti gjumë në sy. Nuk siguroja dot as kafshatën e gojës.

Në "tregun e argatëve" kishim çatalluar shytën e lopata, bel e sakica, kosë e tërnakopë, dalta e çekanë; shkallë e mistri - shikonim ashtu gojëhapur, për punë që do të siguronte kafshatën. U ngjajshim kukullave të dyllta, ashtu duke pritur ndonjë blerës të pashpirt. Me sumbullat e djersës shitnim edhe atë pikë yndyrë, e tokat me çka mbanim edhe shpirtin e carrokëve. Aty rropatesha si në ankth. Dhe, ashtu përgjumshëm dëgjova: "Të gjithë jeni si ky"! S'ka hajr prej jush, as për bukë gojet.... s'e qitni argatin. - kishte belbëzuar Panduri që pështillej në grumbull të argatëve...

- Ani, lene ledinë! - zhurmoi argati.

- Le të pikë edhe pullazi! - mallkoi tjetri.

Kështu ngrisin zërin të papunët, jo si shushurimë, veç bukur ngatrueshëm, si në teh të kryengritjes...

Edhe në Muze çonin dy rrugë e një rrugicë, e cila më tërhiqte më tepër. Andej do të nisesha. Por, populli thotë: "Ruga e shkurtër shpesh del më e gjatë". Edhe Panduri u binte kryq e trthor rrugicave që të kapte ndonjë kontrabandist të vogël. Mbase mua do të më pillte sherr i madh, sepse kjo bredhje ishte rezultat trjtimi dhe detyrash të caktuara. Këtu rreziku i pa matur dhe përgjegjësia vetjake mund të japin mend... se "delen që ndahet prej tufe e han ujku". Bariu kthehet me një më pak, por ata të shtëpisë ia falin fajin, meqë i ka pru të tjerat shëndosh.... Madje, ujku di të bëjë edhe më shumë zullum. U matat e u ç'mata, se nuk isha i veshur bukur. Isha i pastër, por mund t'u bija në sy "zotërive" edhe si shibël që vret syrin çakërr. Megjithatë u nisa rrugës kryesore, ashtu si "pash për pash pazarit" - unë zhelani - argat e kasnec që po zgjohej më herët dhe përgaditesha për të mos qenë i nënçmuar, as i nëpërkëmbur... iu bashkangjita grupit vizitues. Nuk kisha para, as për buletë, por hyra. Droja nga befasitë e mundshme.

Më mbuloi çatia e Muzeut që zbulonte thesarin e kombit. Lakmoja sidomos armët që vizullonin si rreze e nuk di kur ishin fabrikuar, sa gjak kanë derdhur!? Por, më mahniti Piktura e Madhe dhe shumë e bukur, me mbishkrim "Te burimi" - sytë më mbetën në te... gurrë kroi, thashë më vete, mund të bëhet gjethi i lisit, e fleta e bullushtres; fyshti i shtogut, tjegulla, apo rrasa e lëmuar... Por, pikturën e rregullon brusha mjeshtrisht - e bëjnë më madhështore vijat e përhjedhta. Burimi magjik më priri kah domosdoja e çiltërsisë që ushqen shpirtin e njeriut, njësoj sikur të skalitje mermerin, i cili gëdhendet edhe mund të thehet, por nuk lakohet dot. Do ta adhuroj burimin e kthjelltë si pika e lotit, pa frikën e pluhurit, pa gajlen e filtrit të mëndafshhtë.

Koha nuk lejon zvarritje, as bredhje nëpër Muze. As ai nuk premtonte shumë...

Para se të dilja më duhej të ruhesha mos t'i bija në sy ndonjë fatziu që merr rrogë për atë zanat.

Vërejtjen dyfishe ma tërhoqi minarja e xhamisë, përkrh së cilës strehohej Biblioteka Popullora, e cila më joshte aq këndshëm, e aq pak e shfrytëzoja thesarin e saj.

Rruga e shkurtër që çonte në "Tempull të diturisë" mbikëqyrej nga uniforma. Aty nuk mbanin libra "ilegale", por ne bisedonim çështje të ndaluara...

Bibliotekisti jepte librin dhe kërkonte disiplinë.

3.

Në Gadishull nuk gjindej Lima i pa gjysmuar por anije të mëdha. Anija sillej sikur të ishte bisht i gadishullit - utrinë e Evropës. Mbase bota nuk sillet në një anije për hatër të lakmisë, as nga inati i njerkes. Fuqitë e Mëdha - kundërshtarë dhe aleatë bënë "presion miqësor" dhe shtyheshin në sferat e interesit e të ndikimit, kurse Çlirimtarët, me una të ndezura, përpëliten t'i shpëtojnë robërisë. Fjala "bota e re" përkujton dhëlpëren bishtdjegur, së cilës dinakria i bëhet stoli - huqet i lulëzojnë në murriz, si Fanazma që ngul thikën e përçarjes e të vëllavrasjes, shembëllen gjykatoren e drejtësisë së ujkut. Bëhet dukuri e përçudshme: mohon çështjen më të kalbur të errësirës shekullore... bind drejtuesit e Lëvizjes se "tash për tash shtruarja e këtyre çështjeve mund të nxit mosmarrëveshje që çelin plagë të reja, të cilat zhgadhërojnë Frontin e përbashkët - lidhur me dëbimin e okupatorit: Këto çështje më së miri do të zgjidhen pas çlirimit, me mjete paqësore që shprehin vullnetin e popullit"... Dhe, ne ishim bërë hise e BESIMIT TË NDËRSJELLË, ashtu stolisur me rrezet e iluzioneve që çojnë drejt PARAJSES, pa ta

prishur gjumin...

Megjithatë, më kishte thënë edhe babai, në një rast të papërshtatshëm: thërrimet shkunden me rrëfatë dhe, ai që rrëmben një laticë - lakmon edhe copën tjetër... Dhe, "Ulu se s'të han qeni"!?

- Mjegullira nuk është më fenomen natyror, veç avull gjaku...

- Pushtuesi mashtrimin dhe përçarjen i bën pykë, e sundimin sakicë, kurse syleshët presin degën nën këmbë.

Një nënqeshje, ca si ironi e rëndë përkujton vazhdën e mjerimit trishtues: zabeli i prerë nuk kishte dru, as për dërrasa varri, e prozhmi digjej, si hamalla pas të korrave. Okupatorët e kishin shndërruar truallin në tërthore kalimtarësh - mriz për mushka të ushtrisë robëruese.

Ndërkaq, Panduri vardisej pas STRJCËS së Bacës, i cili ia kishte tërhequr vërejtjen:

- Mos prek aty, se të vret Zoti - shnjëzohesh...

Ne nuk i njohim do sende fill e për pe, as mallkimin e Gjyshit që ofshante aq mallëngjyeshëm: Luftës iu thaftë forca, nisma dhe emri! Bartnim strall dhe eshkë, ashtu të zhbiruar nga thundrat e mushkut, brirët e sqapit e dhëmbi i ujkut dhe, në vallen e çakajve të tërbuar. Por nuk u gjindem gand në frontin e çlirimit, ku djelmët e vashat tona kur prishet moti - Erenikun e kapërcejnë pa vig. E Baca nuk fajsonte urat e rralla, as vigun e hollë, veç përforcon rezistencën kundër fantazmës që i ngjanë kukuvajkës, e cila bën çerdhen nën strehë të shkreta...

STRAJCA dukej e madhe, e buka si kafshatë nuk mjaftonte për dy gojë të uritura, kultura zbehej e fronti bëhej më i përgjakshëm.

Herë më turbullohej shikimi, herë zgjerohesha para kohe. Më duhej t'i përmbahesha rendit e caktuar, pa cenuar natyrën dhe karakterin micanian dhe, të kapërceja, jo si pa therrë në këmbë, veç si "të del ku të del". Mbase, as "shllajfitjen" s'e njehja ngecje edhe pse vendnumrimi është vonesë - më mirë "ngutu ngadalë"...

Baca zatetet ndërmjet sprovash të ashpra, por nëpër tërthore e leqe të ngatërruara shpërthen rrethimin shumëfish të shtërnguar. Edhe uniformës, tashmë Strajca e Fukarasë i është bërë therrë në sy, "hënë e përgjakur" që paralajmëron luftë.

- Rezistenca pa luftë të armatosur jehon si shushurimë gjethesh vjeshtuke.

- Por, pse qanë njeriu për foshnjen viktimë të luftës?!

Parësisht njeriu kulturën dhe arsimimin gjithëpopullor i zhvillon në mënyrë që t'i zbuteshin pejzat agresionit, për aq sa njeriu mos t'i bëhett ujë njeriut.

Gatishmëria dhe qëndresa kundër luftës thote Micani çojnë kah uniteti gjithëkombëtar, si qëllim i lartë human. Por nga ana e kundërshtarit - çlirimtarët quhen "rebela", të përkohshëm dhe të paqëndrueshëm. Aq ia prente rradakja edhe Pandurit.

Megjithatë, prirja kah lufta zbret në shkallën më të ultë të përçarjes dhe të sundimit të përdhunshëm; nxit armiqtësinë ndërmjet njerëzve, nga të cilët gjinden krande për zjarrin e fatkeqësisë.

Edhe Qyteti buzë Bistricës ishte i bukur dhe i këndshëm, por aspak i qetë dhe, aq më pak i fjetur. Aty tymonte shtëpiza përdhese e kufizuar me terr e halle. Aty, krahas me simotrat vepronte Baza ilegale e vogël, por me rreze veprimi të gjerë, sa për një Çetë Petritash që çelin vi në vazhdën e luftës kundër helmetave, të cilat errësonin qiellin - toka i kishte rëndë.

Vallë, pse pikërisht në qytetin e adhurar bredhi duke kërkuar "diç"!? Dhe, veproj si "ustah-çarta" por që don të mësojë zanat. E bredhja më bëhej sikur kërkoja diç që më mungon; duke vepruar më imponohej ikja nga diç që nuk e njihja. Të dyjat fenomene të paqarta bëjnë një diçkaje, së cilës nuk ia dija kahjen. Keqas më turbullohej shikimi. E, ecja sa për të ecur nuk premtonte as shteg, as shpresë. Njohuritë e domosdoshme më mungonin, thuaja tërësisht... Ëndërroja shiun që sjell ajam. Atë shiun e majit. Por, kundërshtitë gufojnë, si kërpudhat pas shiut. Kërpudha kishte mbir në sy të Çakallit - tmeron njerëzimin. Shpresa megjithatë brumoste qëllimin, për të cilin isha përcaktuar, pa peng, pa dorëzanë.

Ndrydhja nuk mund të përtrinte diç të re, mbase nën çizmën mizore klyshët e Ulkojës së tërbuar lehnin në gjithkënd dhe hanin gjithçka. Të mashtruarët marrin frymë ngadalë dhe rëndë. Politika dyfytyshe ndërron shartet natën, kurse ditën korrë helmin e urrejtjes e të dhunës. Lën shënja, pas të cilave do të trokiste herë pas here, si për borxh që nuk sosit kurrë - then shpirtin e varfanjakëve, se s'kishte të vetin.

Andaj Baca, me të drejtë thoe: sikur të ishte fituar lufta me çka dhe sa bartë STRAJCA, të parët tanë shumë më heret kishin formuar Shtetin e tyre, jo gjysmak veç të plotëfuqishëm - të njohur e të respektuar edhe nga fqinjët e afërt dhe të mëdhajt e largët. Edhe babai më thote: "hajt se të mëson nevoja"! Por, pa i grahur me ç'ke në dorë, nuk arrihet çka ta kap mendja, aq më pak nëse shkel mundësitë, për t'u shkryer në dëshira...

Pesha e mjerimit bartet në farfurinë e krahëve shtalbë, si "fëmijët hanë mollët e pleqve u mpihen dhëmbët", derdhet zullumi mbi tokën e zezë të nënqiellit që nuk kthjelllet vetëvetiu. Por, lëvizja që shtyn e ngreh, megjithatë po frymëzon forcat e pasprovuara të përfillin realitetin ndjellmirë. Dhe, ky

fenomen ngjalli në vetëdije rrezet që harkojnë unitetin e popujve të vegjel, të cilëve u takojnë terthoret - rruga u bie hise të mëdhenjve që i mëshojnë edhe me të mujshëm.

M'u bë sikur të hetoja se haku në hak mbështjellë një të shtyrë dhe dy pështyrje... të shtypurit përpëliten si hardhuci në pluhur e përzhiten si peshku në zallë. Derdhin gurra djerse për dy gramë dobi, si mundësi që mban shpirtin në pe. Nuri i viktimës që "dridhet në litar" i klith kushtrimit, ndërsa fosfori i rrashtës reflekton dritën që del nga varri i rrafshuar... Tërheq vërejtjen se lufta për liri ngarkohet me sakrifica, por edhe mund ta ndryshojë jetën, sidomos me fitoren e pavarësisë kombëtare.

Përkundrazi argatët e lidhur me pagë nuk ia dalin dot me pushtuesin që bën zëvendës Kapisuzin, duke ua rrotulluar burimet ecurive ë zhvillimit. Harron se "Rrota është e rrumbullakët" e rotelët strehohen, si miu në rrotë të djathit.

Klyshët e Ballkanit gjithashtu mbështetur në "Shtatë evropat" ngatërrohen ndërmjetveti rreth ndarjes së presë që shnukin çakajtë nga timaret e arbanëve: mallë e gjë të gjalla, si dhe tbanat me gjithë trojet e të parëve tanë... E Micani, pa shpresë gjallërimi hamendë të bëjë "diç" si "mishi të piqet e helli mos të digjet", i bindur se pa mbështetjen e ndonjëherit nga të mëdhajtë nuk u dilet në krye çakajve që i mbëshojnë pa hirin e Zotit, pa mëshirë të shëjtit...

Dhe, SKIFTERI i "Bjeshkëve të Nemuna" ose fluturon një ditë - të veten - ose do të dergjet si laraskë, të cilën e shnukin serrat e zeza në bjeshkë e në vërrin...

Rrëxohet një -

Çohet i dyti

Pip në këmbë,

Si shtyllë graniti!

Baca me pakëz vesë të atij mëngjesi don t'ia freskojë rrënjët e trandofillit të vyshkur nga zjarri i rrufesë që vriste ashtu pamshirshëm. E arbanët thithnin rrufenë, si të ushqeheshin me zjarr...

Vret edhe uniforma e plumbët djathtas e majtas - ç't'i del përballë. E Sllavojës i plasin sytë kur sheh shtalbat që i bëhen qoshe PYRGUT të qëndresës.

Deshta të këqyrja punën time, por më thanë se nuk isha i vetmi që i pengoja në të tyrën; ia dola disi... u inatosa se isha jashtë konkurrencës dhe nuk i respektoja rregullat e "lojës", në të cilën i madhi ka fjalën, kurse i vogli fshisën...

Edhe Micanit, para se t'ia mblidhnin betë, nga ballë për ballë i dilnin pas shpine... Mbase edhe zullumi ka kufi... Madje, e drejta e shqiptarit është e vërtetë e idhtë, si dhe skamja me nafakë të prerë... Por, hisen time as xhinsi im s'e lën të shkojë si miraz pa trashigimi.

- Eh, shytan i gjorë! Ku ke parë që një fuqi e madhe të sakrifikojë Përandorinë për laticat e rjepacakut që don të hyjë në Pallatin Mbretëror me një gjysmë opinge e strajcën kraheqafë?!

II

FANTAZMA

1.

Diç që kapet me mend, si ankth trishtues, ditën për diell, pa gjumë në sy, pa mend në krye frikson njeriun, duke ia humbur pusullën që t'ia hante edhe kokën endet në horizonte të kapërthyëra. Kapërcejzat enigmatike, si kolerë e përshtatur natyrës dhe karakterit të kokave të krisura i përfalen MESJETËS. Dhe, Akrepi smirëzi përulet duke belbëzuar: "Prite Zot prej meje", kurse argatët derdhin djersën e angaries. Fantazma e shndërruar në UNIFORMË kosit gjithnjë dhe gjithkund: gra e fëmijë, të gjithë meshkujt e qytetit dhe të fshatit, pas të cilëve nuk mbetet macë që ta pren rrugën, as gjel që këndon maje gardhit të oborrit. E qyqja vajton mbi pullaz të Kullës, lejleku ngreh çerdhën mbi oxhak të fikur.

Mjegullira e dendur pakson të pamët, ndërsa një gajle e kahershme ngadalëson frymëmarrjen... Fantazma nën velin e bardhë nusëron mashtrimin, për t'i mbetur besnike pushtuesit që kallë mjerimin. Uniforma e sakicave dhe e kryqit të thyer zaptin tokën, ujin dhe qiellin, ku do të gjente dash pa brirë, qengj që thith ulkojnë dhe, qen pa dhëmbë. Në ironinë e mashtrimit luan vallen e fatit të popujve të nëpërkëmbur.

Zjarri i kallur lën pas veti shkrumbin e tbanave - trojeve të shkretëruara; ndërsa çakajtë shtyjnë huqet e veta e vëjnë në peshojë krimet, pa u marrë vesh kryet, për të reshura, as shtëngatë, për hakun që gllabërohet pa pardon. Bashibuzukët bëjnë rrah zabelin e krasisin pipat për të shtuar "sojin" që flliq kah t'i shkel thundra e zezë...

Nëpërkah thith gjak e vjell helm; shterrë mushtin e shorteve e nxion të mbizotërojë kopshtijet e botës. Stërkeqë ndjenjat e urdhëron xhelatin ta kryej krimin, në mënyrë që ë shkumojnë buxhillat e gjakut, helmi të vlojë në majë të bajonetës.

Në sulmin e pushtimit shkelë tërthore e zë nyja kyçe që të ngushtojë rrethimi i të nënshtruarëve. Urrejtja i zë majë vdekjes. Ajo nuk njeh urtësi, as dritë nuk ofron, veç zhytet në kënetën e mjerimit. Dyshimi brenë marroçët e dhuna nxit tragjedinë mizore, përdhos ndjenjat e njeriut, sjelljen dhe nderin e të shtypurve.

Krimi bëhet për asgjë, por populli jep të mundshmen, ashtu siç don vetë: një hise që të kalohet shtegu,

me tjetrën të skaliet qëndresa... të mbahet shpirti gjallë. Njëherazi përçohet zgjimi, rinia i kundërvihet pushtuesit, ashtu giximshëm, pa kursyer forcat shtalbe, pa drojën e "përparësisë së Firerit"...

Në shpërthimin e rrathëve ë territ shquhen "Sqipot" syshkëndijë - përtrihe xhinsi micanian, si rrëxohet një - çohet i dyti... marrin mend e forcë për më tutje...

- A po e sheh uniformën?

- Po, po! Ende shoh... pakëz turbull...

- Qysh jo! Kur t'i bëjnë sytë mjegullë njeriut edhe mund t'i "ngjitet dora për tjetrën"... kryet i zvarret si pocërkë në gardh. - vërejtji njëri nga të sprovuarit.

Nxitova kah Baza që të përfillja "diç" të pa kryer. U graha këmbëve, e bluaja me mend. Ndërkaq brinoçët bërlykeshin ndaj viktimës sikur mos të kishte kush t'u dalë në mejdan!? Rrafshojnë mëkatet duke shfryr urrejten - shovinizmin e dhunës. Bashibuzukët shkelin e dhunojnë - sillen si t'i shtynte instinkti, pa përfillur vazhdën e praktikës që shënon gjurmët e njeriut, jo të mushkës.

Rinia çlirimtare zhgojon njëren anë që të shpërthej nga të dyjat: përforcon krahun që çon në këmbë vegjlinë dhe përfillin mëvehtësinë kombëtare. Kështu mund t'ua këpusin nafakën pushtuesve dhe shtinjakëve që ecin si në këmbë të huaja...

Vërehen shumë sende, të cilat për një ças më dukeshin formale, por praktikisht tërheqin vërejtjen që mos të bëhet miza buall, as e vërteta cikrrim. Kuptova gjithashtu një hisë të dinakrisë, por jo edhe qëllimet strategjike të pushtuesve të dyfishtë. Në domosdonë e krijimit të Frontit Çlirimtar më ishte tretur dyshimi ndaj thikës pas shpine, kurse ndaj vendasve që shtiheshin si enguj, por t'i lenin këmbët e arushës në dorë... do të më dridhej dora sikur t'i godisja me gurë para se t'u jepja bukë me dorë në zemër. Mbase po t'i vriste buka ime nuk do t'u gjindej ilaç për ndërgjegjen e prishtë të tyre.

Përbindëshi i zi, si ari i plagosur, do ta bëjë fshatarësinë rrëfanë për gogishte e punëtorinë mish për topa; rëndon shtypjen duke nersyer langojtë, si në gjah edhe pse vetë është i gjuajtur.

Shquhen veçoritë, nëpërmjet të të cilave përçohet jehu i pranverës micaniane. Petritat qëndrojnë në mënyrën e vet eshtrat ia falin truallit, i palojnë në kopshtin e vëllazërisë, mbase gjallëria nuk shuhet dot, por mjegullon...

- Prirja e ndërgjegjshme mbërthen më vete qëllimin përkundër tërthores që thellohet në bungajë...

- Megjithatë, fitoren e veson agu i lirisë që ngjesh besimin e ndërsjellë - bëhet hisë fatbardhë e popujve

të vegjël, të cilët ecin mbi tokën e vet.

Urrejtja megjithatë nuk njeh besë, as burrëri. Madje, as luftë nuk njihet pa zgjuar burizani ushtrinë që të dihet kush kujt i del përballë. Dhe, Baca bëri hapin e parë, pa i prituar rrëmujës, pa drojën e fantazmës që merr krye si brijenë e tërbuar. Por, mungesa e përvojës ka gjasa ta plogështojë nismën ndjellmirë, ndërsa shtegu i dritës ende është pas reve të zeza. Takati i hollë s'e shpërthen lehtë terrin e dendur; sepse tehu i kësaj lufte mprehet me rezistencë, por shuhet me gjak...

Fatalizmin ndaj vdekjes e lidhem me fitoren kundër pushtuesve. Por, shtypja e imponuar nxiti domosdonë e luftës për liri e mëvehtësim të pamposhtur edhe pse moti i grishtë brenë çelikun, si teja lëndën e moçme. Megjithatë nuk na lëshon zemra, zjarri na rralloi... Flaka e revolucionit kalit qëndresën, pa të cilën nuk shporret dot robëria. Mbase Kuçedra zën ngushticat për të mbizotëruar gjerësitë.

Përkundrazi, Micanët ushtrojnë durimin e qëndrueshëm që u ngjanë Trafostacioneve, të cilat ushqejnë linjat e elektrizuara për kontakte "pa kushllus". Ashtu aftësohen "shëgerta", mjeshtër e kryemjeshtër, të cilët nuk do të zhagiten nëpër rrëshqitëza; nuk mbërthehen dot në bigën e përçarjes, as të ngujimit. Mbase për një zjarr shkatrues mjafton një xixë strall me një thërmi eshkë të terur pranë oxhakut që tymon.

- Përcaktimi pa luhatje majtas - djathtas i jep vi përfilljes ndjellmirë...

- Pa të majtën edhe Prijatari mbetet i gjymtë, kurse edhe pa të djathtën gjymtohet tërësisht.

Edhe në shtërzimet e besimit të ndërsjellë zën rrënjë mëshitetja e pathyeshme, në mënyrë që e majta si këmbë e dorë, me të djathtën si sy që shkrep dritë i përfalen mëvehtësisë, pa të cilën nuk ka lëvizje, as fitore. Ndërsa gjallëria i ngjanë lumit që vërshon rrëmbyeshëm, i cili pasi ta ujit fushën qetësohet për lundrim.

Megjithatë, po të përzihej "Fodulli" në politikë, dije se do t'i frynte zjarrit të luftës së shenjtë...

Fantazmës i bie shi në kallamoq, mbiell terr e gjak, duke rrezbitur takatin e të nënshtruarëve - imponon ndërgegjen e brishtë: tokën e bën varr, detin llavë vullkani, e qiellin amshim misterioz.

Pushtetmbajtësit i mëshojnë kryq e tërthor, pa gajlen e premtimit, pa dhimtën e viktimës. Mohojnë të vdekur e të gjallë, sikur mos të kishin nënë as baba, motër as vëlla, as troje për gjallërim. Presin humbjen përfundimtare - ditën e kapitullimit, kur zvarret kryqi i thyer në sqep të korbit...

- E gjatë është kjo rruga jonë bir-o! As Kullat nuk i ndërtojmë vetëm për një ngujim. Ato i bëjmë

kështjella të qëndresës kur s'kemi shteg tjetër, e luftojmë, si "Ja vdekje - Ja liri"! Për jetë më të guximshme dhe më të lumtur. Djelmë e vasha lindim që të rriten pa drojën e fantazmës që palon urrejtje e shprazë mllef në plagë të pezmatuara. Mbase zhagitja "ngreh e mos këput", prit sa të del dushku e tjera janë huti, që sjellin dyshim dhe humbje që merr me vete edhe kryet.

Im atë, i urtë në dukje, nuk ngucte, as nuk rëndonte askend. Nëse dikushi do t'i prek në tel - s'i jepte tehir - gjykimin do ta bëjë vetë, pa i vajtuar prapa. Ai nuk bënte lutje, as ankesë...

Në tollovi brktisi Kullën dhe gjallërimin. Mua më barti në një rën anë të duqëve, mbi vithe të vraçit e unë jam i vogël, por bir i Babait që burrërinë ma la amanet: Batarja e preu - fjala në gojë i mbet! Dhe, për çka m'u paska shar lulaku i djepit?! Për çka ma paskan grabit lirinë. Dhe për çka paskëm qenë dëbuar nga vendlindja? - Ofshani Baca, me mllefën e ndryrë në zemrën e plasur aq mizorisht...

Fantazma e zezë zgjedhte uniformën që u përshtatej çakajve: të kuqen, si dukuri që i përngjanë perëndimit të diellit dhe, të zezën e urryer që manifestohet në varrosje të përmortshme. Madje, nëse rrasen sllavojsit edhe si miq në konak... të nesërmen - thote Gjyshi - t'i qesin mitë në ledinë... të bëjnë tokë që ta harroje edhe qiellin.

2.

Krasitja bëhej krahas me procedurën urgjente që provon nga liria arbanët, të cilët pushtuesi i hedh në gropë të qereqit që t'u regjeshin eshtrat. Mbase kush pret mëshirën ia han djalli shpirtin; çka mbetet gjallë do të bëhet argat i angaries. Politikaxhinjtë përgëzojnë zonjën dhelpër, e cila kallajit mashtrimin, kurse bashibuzukët mbjellin përçarjen e trullanët i kap grei i përgjegjesisë...

Nën drojën e fantazmes Grupi i të rinjve antifashistë, ashtu furishëm çarmatosën Njisitin e karabinjerëve që vinte nga Gjakova e Kuqe në drejtim të forcave të "Fererit", në mënyrë që trupat e Mbretit Imperator do t'ia shtonin famën Kryqit të Thyer...

Dhe, nuk deshti fati të bëhet më keq. Njohja e gjuhës italiane nga dy anëtarë të grupit që kryente aksionin, si edhe frika e përqëndruar rreth shpëtimit të jetës së njisitit që u dorëzua pa kushte shmangën tragjedinë. Aksioni përfundoi shumë shpejt dhe pa pasoja të kobshme, mu në çastin kur korbi kroat pas viktimës...

- Nuk bën t'u dorëzohemi civilëve!? Nguli këmbë ushtaraku.

- Dy ushtri... janë larg... e zeza në qytet, ndërsa "e kuqja" në rrethinë. - theu akullin i riu syshkëndijë.
- Dorëzoni armët! - ndërhyri, si pa rend, idhnaku...
- E pa mundur! - u ngërdhuc Aspiranti i rënë në grackë.

Njisiti i ushtrisë së kapitulluar dorëzoi armët që të shpëtonte kokën e krisur...

Mëdyshjet e mbarrsura me vdekjen ndjellnin rrezik, por gjakftohtësia dhe ngulmi, si "ose - ose" shndërruan dramën nga tragjedia në përfillje. Tre a katër djelmosha u pajisën me revole e karabina. Të tjerët, ashtu pa numëruar armët, pa peshuar rrezikun stivonin karabinat e lakmueshme në misrishten pranë xhades, gjithashtu pa kurrfarë sigurie.

Ngjarja mbante më vete rrjedha që shquajnë veçoritë individuale, të cilat duke u shkrirë në cilësi të kulluar kalisin përqëndrimin e bashkimit që bën fuqinë.

Bacës i shihej për të madhe që shpesh shoqërohej me individë të pa dëshirueshëm në sy të uniformës; ndërsa ai bëhej shurdh-nemec dhe vetmohueshëm kryen përkushtimin përkatës. Nuk befasohej që xhandari përshëndet kerrin e UNIFORMËS në kalim, kurse populli i dron xhandarit në praktikë...

- Çfarëdo eksperimenti nuk jep fryte të këndshme, pa qenë i shartuar me pipa të urtësisë.
- Njohuritë sado të pakta të jenë begatojnë natyrën dhe përforcojnë karakterin burrëror, kurse lidhmëria ndjellmirë afron popujt në përpjekje për paqe e harmoni - mirëqenie të domosdoshme, ku solidarësia shlyen mëni e kufij, inat e përçarje. Urtësinë e mbështesin në virtytet e larta humane që nuk qiten në harresë, as nuk mohohen kurrësesi...

Krisi dera... Baca, pa përshëndetur, pa çelë strajcën që të ofronte: bukë, kulturë e barot, ashtu siç e bëri zakon, veç kërkoi "lidhjen"...

Më përshkoi njëfarë droje, meqë shqetësimi ishte i pranishëm. As nuk përsëriti përshëndetje si rëndomë, veç la të kuptoja: më pak iluzione dhe shumë kujdes, për punë më të qëlluar, sidomos ndaj qëndrimit të pushtuesit.

Në këto ndërmjetëza nxirrnim një përfundim: sa më i pagëdhendur të ishte kryet, aq më i vrazhdë bëhej dëmi. Ndoshta thërmoheshim pas gjërave që shpesh nuk i kuptoja: shkelnim në imtësi, të cilat çojnë shibla që vrasin mendjen... Vrapoja si pas një kokërr dardhe, e cila më ngatërrohej me bombën që tremb dy të gjorë, njësoj si ë hudhej dardha e i urituri ta rrokte bombën dhe anasjellas. Dyshimi brente, si më dy teha - uniformën, së cilës do t'ia "dhuroja" bombën që të më mbetej dardha...

- Paragjykimet dhe bestytëritë mund të kurthojnë kryerjen e detyrave - topisin nisjaivën.

- Më bindshëm do të bëhesha "sy e veshë", sikur të kryste bomba jote zhgëndërr.

Droja krijon huti: në qiell fantazma, në tokë uniforma... sikur e para të fshinte mjegullirën, e dyta humb pusullën në të panjohurën. Ushtria e zezë shkel tokën dhe njerëzit që mallkojnë djallin dhe qiellin që nuk kapërthehet dot. Zekosi katërvjeçar i gjatë matej me kallzit e jetës në fitoren e quajtur liri.

- Mllefi që bëhet ushqim, doemos prodhon sadizmin që mposhtë gazmorët...

Një politikaxhi - zog politikanit - nepërkë e inatosur ia mbanë anën uniformës, mbase ajo dhuron nga një shenjë e dy premtive: bashibuzukëve të vegjël u jep tokë për eshtra, kurse të mëdhajtë i bën "mëkëmbës" të vegjël. Ndërsa një hise e të vegjëlve, si gjithë të shtypurit krrusën ashtu dyfish nën mëshirën e fatit, se "ka keq e më keq"; pjesa tjetër zhagitet në kolovajzën e shpresës, pa shoshitur hallet, pa qitur dorë mbi krye...

Vërshojnë KORBAT si karkalecat në ë lashta: dikushi do t'u besojë gënjeshtreve deri në zhgënjim; shumica duke mos e kuptuar meselenë bie në grackë, si "dy maca hanë një qen"... kryet çyqë merr qenin, edhe pse fjala lidhet me një padrejtesi që u bëhe qytetarëve të pafajshëm: dy të ligj derbeterë ia marrin anën të fortit që ka edhe të drejtë - personifikohen me ligështin e qenit që ngopet urrejje dhe shfren mllefin: "njëqint për një"!

3.

Në mjedisin e prapambetur Arbëri lufon për të drejtat e veta dhe të bashkëvendasve. Mirëpo një hise e "Parësisë" bredh për të gjetur padron të ri, kurse hisja e panumruar thellon humnerën - ngri zërin që nuk shuhet dot. Forcat liridashëse veprojnë në hapsirë të kufizuar, si në ngushtica të pakapërtheshme. Megjithatë ngujimi në Kulla guri do t'i ngjante vetvrasjes. Vetëm shpërthimi i rrethimit mund të kishte kuptim. Mbase Lëvizja e guximshme përballon rrezikun ashtu pa kursyer gjakun, pa thyer shpresën. Heshtin frangjitë e përgjakura - kumbon zëri i arsyes.

Megjithatë, shfaqet fantazma si korb i stolisur "me pupla të huazuara", por në përplasjet e gazepit ia shnukin një nga një - secili don të vetën, e korbzeza i cullakosur merr aratinë për t'u strehuar diku nën PASHALLËKUN e mallkuar. Lën "rajën" në mëshirë të fatit... ndërsa arbanët dinë të lavrojnë, e toka u takon atyre që punojnë. Korbat megjithatë zhveshin tromakët e misrishtes, kurse çakajhtë ndiqen nga të

lashtat, si karkaleca dëmtues. Por, nën hijen e fantazmës një shtrigë, duke ua ngrënë ushqimin, i lën të vdesin nga uria foshnjët e strehuara në fushimin e vdekjes.

Shtrëngata turbulloi kthjelltësinë që ngrit vetëdijen për qëndresë, siç e kanë zanat arbanët, të cilët kthejnë mbrojtjen në sulm, e thyerjen në fitore. Fantazma tashmë shfaqet si përbindësh që ecën në rroshkulla; sillet sikur njerëzimi mos të kishte sy në ballë. Bëhet grumbuj grumbuj, si çon urithi në livadh, e shpërndahen si milingonat që vërshojnë kah t'i çojë instinkti. Lëshojnë si anëza helmuese, e helmi fryhet kodër që zën diellin; me plumb sharrit zabelin, e sakica laton zgjedhën.

Imperatorisë po i zhdredhen tela e çekërku, pa dhimtën e brymës, pa hatrin e diellit. - theksoi Arbëri duek tërhequr vërejtjen, se Kuçedra e zezë me gjakun e çlirimtarëve po shkumëzon valët e Erenikut. Një hise e Micanëve kalbet në tokë; çka shpëton nga zjarri regjet në angarie.

- I nderuari nga frika zënë në thua në "kalbësirat shoqërore"...

- Edhe mahia merret si gjysmë e vërtetë, por hamendja të lë në gjysmë të rrugës.

Arbanët përkundrazi bëhen hise e Unitetit Kombëtar... ecin nëpër zjarr, si mos t'u ngjitej gaca.... trualli i pajis me begatitë e mirëqenies e ata Këndojnë:

Shadërvan, o burimi plak!

A s'do t'dhimbet gjithë ai gjak?

Që po derdhet si gurra jote

Aq krenar në këto mote...

Një terr i zi i përcjellë me rafalet që vjellin plumb errësoi Qytetin buzë Bistricës. Po rrjedh gjaku i ngrohtë i çlirimtarëve, të cilët përdanin tymin e eshkës, shitojnë FANTAZMËN që bredh si krimbat në mot të lig, e mjegullirës nuk i njihen huqet; nuk ka qartësi kurrfare. Lufta lëndon shpirtin e të nëpërkëmburve, të cilët i japin gaz qëndresës, kurse fantazma zë diellin e shkelë njerëz dhe tokën. Kullave ua shtin flakën, e carrokët përcillohen për së gjalli.

Vigu mbi Erenik u jep zemër djelmoshave që kapërcejnë lumin e rrëmbyeshëm. E baza mbanë lidhjet. Forcat lëvizëse përçojnë rrymën "këtu" që të shpërthejë "atje".

Çlirimtarët marrin malin që mos t'u mbetet fusha djerrë, kurse një hise e "Parësisë" i bëhet kambanë pushtuesit, prej të cilit merr falas nga një shujtë të idhtë. Dhe, nisma jonë është e gjatë, por edhe ngashryese, si "borxhi i vonë gëzon të zonë". Prapavia bëhet burim qëndrese, nxit hapa më të guximshëm. Sa më i përgjakshëm të bëhet zekosi, më shumë shkëlqen kosa e mprehtë, si umi në lavren e bukës së re. Ata që i han lufta lënë pas veti hisen, kurse të plagosurit me një dorë luftojnë, me tjetrën shërojnë plagët. Aftësohen për qëndresë të dyfishtë. Megjithatë ndodhë që "krimi quhet gjë normale" i njërës anë dhe, pajtim me fatin e zi për anën tjetër... ndërsa besimi i ndërsjellë mvaret nga praktika jetësore. Mbase lidhjet më të sigurta krijohen në ballë të luftës kundër pushtuesit. Aty qesh fati që shndërron thyerjen në fitore.

- Aty përjetova ankthin e luftës... Hisen dhe jetën ia kushtova vëllazërishtes - varfanjakëve gazmorë.

- Hapat e përgjakur shquajnë trimërinë e djelmoshave dhe vashave shqiptare që shpërthejnë errësirën shekullore. Një grykë mali bëhet si dy shtigje të pakalueshme. I pari sosit në prag të humnerës, kurse të dytin e mjegullon mashtrimi - dredhia që josh të nënshtruarët me djallëzi, ku thejnë qafën të gjorët. E Baca rryhet në gaze; nga vuajtjet nxirr takat, nga terri dritë - i përfalet horizontit të mirëqenies dhe të harmonisë ndërnyjerëzore.

Prapa Portës së Qytetit bënte një "Post-bloku", nëpër të cilin me leje kalonin të dyshimtët, pa leje ilegalët... lirisht mund të kalojë vetëm ndonjë Petrit trim që do ta puth truallin për mallë të babait... Dhe, Baca shtrëmbëron kësulën e bardhë mbi syrin e krushkut që ecën përkrah varrit të çelur, ku një gramë besim peshon më rëndë se një thes dukat. Aty rrëmon fantazma... shpirtat e uritur për gjak gjurmojnë Shpellat Mesjetare - zhyten në mjerim:

Fill pa zënë

pa çelë vi

këndon qyqja

ndiellte zi...

Dhe, vetë i mëshoj pa nënën time të dashur, pa babain e urtë...

Oh, sikur të mund ta pyesja "diç" nënëloken - grua e burrë, nuk do t'i rrudhja krahët: s'di...

Oh, më lehtë do ta dëgjoja ngushllimin tënd: "Më mirë skifter një ditë, se sorrë përditë"! Kështu, bile do t'u jepet rend atyre që çelin vi. Dhe, me të drejtë thuhet, se të ngathtit i vinë ment mbasi të dalë prej gjyqit, gati si "Mos u bëfsh të të qajë i padhimshmi"! Por, nëse t'i pin sorra ment edhe gjeluca ta këndon "kikurikun" përmendësh.

- Që keni një xhins fisnor - një komb të lashtë - e di por çka iu lidh aq ngusht me të tjerët!? - vërejtji njëri që ende s'e kishte shijuar çorbën e të vërtetës së idhtë.

Hëëë! Njeriu në trup të vet ka dy këmbë, një krye e dy duar dhe, pse mos të kishte njerëz të urtë që i japin dum pleqërishtes, ku "Uni" im Dhe "Uni" yt bëhen "ne" - një largësi afrim - shumë krahë që përgëzojnë bashkarishten, si "trimi i mirë me shokë shumë"...

Bashkarishtja në luftë mund t'i ngjajë ujemit të blojës pa rend, por paskaji zor shkoqet... mbase çka ngjitet në sprovat e zjarrit nuk thehet pahiri.

Hetova se arbanët ecin dhe u ngjajnë degëve që thithin mushtin e trungut, rrënjët e të cilit nuk i kalbë moti i brishtë. Përkundrazi edhe acari ngrit gatishmërinë për mbrojtje, kurse të parët tanë shytas mësynin shtegun, plumbit ia hapnin gjoksin...

Ngujoheshin në Kullat me frangji të përgjakura; aty ternin eshkën për strall dhe shpresën e mbështetnin në truallin e babait e në djalin që shton hisen...

E trojet micanjane bëjnë brrylat e UDHËKRYQIT? ku drejtohen kthesat e mprehta, pa të cilat s'ka të vërtetë të idhtë që mund ta shohë dritën.

Kështu e nisi, e kështu do ta përfundojë edhe Sllavoja, i cili hypur në kali të shaluar, çmonte sa grurë prodhon secila parcelë e arave të xhinsit tim; cili zabel jep lëndë për QYPRI TË KULLËS, për vig, apo për urë mbi lumin e rrëmbyeshëm. Cilat Male do të përgjakeshin më shumë për t'u quajtur "Bjeshkë të Nemuna", mbi të cilat shkrep dielli që nuk nxenë njësoj.

Përseritet fragmenti i këngës së pa kënduar:

Motet rrëshqasin si bryma para diellit

Palohen shekujt e mbishkrimet mbi rrasa

E xhinsi përtrihet - çelin lulet e Blinit.

Ecën, ecën arbanët dhe dinë të prijnë drejtë rrafshit të pa trënuar, ashtu kah shtegu i dritës...

Në hapin e parë u ngushtohet rrethimi, me shënja të veçanta e gurë varri: lindje - vdekje - lindje... me hambar që s'e përthekon bukën e motmotit; ecën e luftojnë për ekzistencë.

Pa shtrirë të dytin - hap - përkuqtojnë prangun e derës, qyskinë mbështetur për qoshe të Kullës, mullarin pa i zën majë...

Hapin tjetër shtrijnë më gjerë dhe më guximshëm: ecën çuditshëm dhe qesin rendin në rrafshin që ka bregun e vet.

III

ZJARRI QË ECËN

1.

Besoja se durimi qet në dritë diç të vlershme, por sa para bën fryti i nxjerrë për gazepi, si vuajtje që nuk përtypen mësa hanxhari i mizorisë. Durim madje, i thonë qëndresës që shndërron shkatërrimin në fitore, kurse zjarri lë pas veti hinin. Zullumi mund pajtimin, duke kallur zjarrin, nga i cili shpërthen mosdurimi që çon në çmendirë, pa hatrin e mirëkuptimit, pa mëshirën e zjarrit.

Natyrisht arbanet ushqehen me qumështin e nënës që nuk trembet dhe përshëndoshin babain dhe trojet që bëjnë tërësinë arbërore. Dhe, të bijtë "qitën sytë në kodër", se nuk janë të hartuar që gjithnjë t'i kuptonin të tjerët, pa pritur që edhe këta do t'i kuptojë dikushi. Por, përgjakja më e shëmtuar dhe shpërnguljet më të tmerrshme u rendisën nga Rrafshalrta e Kosovës deri në shkretiratt e Anadollit dhe gjetkë, mu për turp të Sllavojës së Ballkanit, për praktikën marroçe nacional-shoviniste të sllavizmit mizor...

- U shoftë praktika që nxit marramenthët pezmatojnë plagët e pashëruara - krahët iu thafshin kuçedres gjakpirëse! - mallkoi Gjyshi.

Përskaj rrugës pa krye, nëntë varre pushtuesësh me nëntë koka arbanësh - të prera ashtu mizorisht dëshmojnë krimet, të cilave u nënqeshë "Hëna e përgjakur" që mjegullon shtegun, ku arbanët i bëjnë roje Mëmëdheut. Ushtria pushtuese në ikje nëpër malet tona shkatërron Qytetet e shkelura fshatrat i djeg e fëmijët në majë të bajonetës...

Kreshtat e majeve të pashkelura dëshmojnë se s'ka ushtri që t'i kalojë pa u bërë mish për korba, mbase SHQIPONJAT nuk vardisen në stërvinë. Ndërsa rrashtat lozin vallen e mjerimit, sllavojsit stolisen me reliktet mesjetare, për ta bërë të pushtueshme hapsirën që kapërthen nënqiellin e vendlindjes, ku shtrihen trojet e xhinsit tim.

Dhuna e mjerimi veçojnë sundimin mizor që vulos dufin e kryqëzatave të ashtuquajtura luftë e shëjtë që ushtron pushtuesi ndaj të gjorëve tjetërfare. Aty ngulet thika që shkallon trungun, e ashklat i derdhen pranë....

- Toka të bënë tokë, bir-o! Por, QARRI i truallit të jep drrasa varri e në përshëndoshim farfurinë e plepave që falen duke lutur Zotin mos ta ndalojë murlanin që turbullon shtegun e dritës...

Dhe, pyesja vetëvetën: Kush dreqi qënksa vetë?! Unë! Hutaçi që i këndon Skajjit të vet në paskajshmërinë si ndërmjet tokës e qiellit, ku jetohet veresi - puna quhet angarie... dhe i thua veti qytetar me të drejta të barabarta - urbane, ndoshta!? Dikushi brenda natës bëhet i famshëm, e tjetri fiket ditën për diell - merr krye "rendi" i quajtur dhunë, shtypje e gllabërim... Fajsohet natyra e fisit që ka shumë krerë e pak fshatra. Nxehet gjaku e përseritet faji... jeta vazhdon: lindje - vdekje - lindje... punë praktike - "jetë e qenit": Pas urrejtjes - zjarri që ecën... skamje - skëterrë... durim, jo përulje - qëndresë aktive që ia kalon asnjanses, përplasje me ushtrinë zaptuese.

Në luftrat e përgjakshme, si ik e ndiq, një hise e xhinsit tim i bëhet kurorë grykës së topit: një hise fërfëllohet si guri në bahe. Por hisja madhore nuk bëhet dot fyshekzar, as "fyshek çorr" që vret gand, ashtu si pahiri... Edhe pse Arbëri duke lavruar tokën gjenë rrashtën që trishton të gjallët, të cilët bubrojnë për kafshatën e thatë... të vetën e të carrokëve. Por nuk lavrohen varrezat, mbase bukës i vjen era mejt...

Edhe Princi "shpëtimtar" e prishi punën me veçilët e popullit kur tha: "Në kohën e mungesës sime, Komisia ndërkombëtare do ta marrë në dorë sundimin"?! Ndër shekuj u rrokullisëm të sterzhgënjyer... Ja besuam lakrat dhisë - ajo i bëri rrah - ujku ia fshiu dhëmbët asaj, sulmoi edhe të tjerat... t'i qitte fare...

Në kushtet e përbuzjes së shëmtueshme, ashtu të nënçmuar xhinsi micanian ka ngritur zërin që mund të dëshmojë: së pari, ai që ka mbaruar vegën para vegshit është mashtruar rëndë. Ajo vegë e papërshtatshme i ka mbetur në dorë trilluesit, si peng i hamendjes. Mbase vetëm ai që bën vegshin, siç thotë populli - ia mbaron edhe vegën, dhe, së dyti, kush mbështetet në forcat e trojeve të veta mund t'i rrit të bijtë që t'i dalin zot vetvetës, truallit dhe mëmëdheut. Megjithatë, leqet e dredhura mjeshtrisht nxisin djallin të dalë për ledinë... Sprasmi, Sllavoja në njëren dorë mbanë eshkën e më tjetrën zjarrin - arbanëve u mbinë therra në derë të konakut; sofren ua shkel dushmani, në mënyrë që përbuzja nxit urrejtjen që ndërthurr leqet e përgjakura. E hijena duke coptuar një kufomë - lën hapur gropën për një tjetër viktimë, e kështu me radhë... pa çmuar se "Kush ia bën gropën tjetrit - bie vet në te"! Kështu thonë të moçmit, e askush nga "të rinjt" ende nuk e ka vërtetuar të kundërtën...

Një ujk, të cilit qengji gjithë ia turbullonte ujin prej së poshtmi bën krimin dhe vazhdon të trillojë situata të acaruar... mbahet i paprekshëm, si qoftlart që s'din ç'është pendesa, veç i mëshon koturo derisa t'i shkojë kungulli mbi ujë.

Lidhja, si Besa - Besë bën rrjetin - lëvizje e Petritave që i shukati pabesia - nënçmimi, të zhgënjyer, pa njohur fajin, pa zbërthyer enigmën. Brente "teja", së cilës nuk ia dija huqet, e as ajo nuk më bënte

hesap. Do të më zhgulte rrënjësh për faj të vet, si xhins që s'përket me farën e korbit... e zhagitesha i ndjekur nga çakajtë e tërbuar thote Micani, si ta vajtonte qëndresën, ashtu i pa epur.

- Ujku don mjegull! - më kishte thënë një fshatar që bubrronte si milingonë, e ç'kishte pas shpirtit ia kish lënë amanet Kryehajnit të Qytetit... Ecte ashtu si siluetë e gjallë - njeri i rendit të dytë që han pak e çon rëndë... zihet në lëng të vet... E Sllavoja nersente çakajtë... Një rrjedhë fatzezë, për të gjetur ndonjëfarë zgjidhje u bë vazhdë gjaku e quajtur SHPËRNGULJE. Po, shpërngulje e shqiptarëve nga trojet e veta, ku do të seliteshin sllavojsit e jugut. Ata kushtëzojnë zbutjen e murlanit të veriut që bart në krah zjarrin jugor.

Gjahtarët e tërbuar tundin mykun e nëntokës dhe, me reliktet e shëjtit stolisen si korbi me pupla të huajtura. Pason e vërteta e idhtë: shpërnguljes i shtohet pezmi i dhunës, kurse rezistenca paqësore përforcohet me qëndresën që farkon kurajon civile... rrjeshtohen Petritat në roje të Mëmëdheut.

Aty QËNDRESA e durueshme qëndis HIJESHI në xherxhefin e nusërisë që përgëzon duart e praruara. Ato nxjerrin fitim si ndërmjet mishit e thoit - del se edhe në ari ka çka tretet, mbase ari kullohet në cedillën e djersës së ballit të çiltërt. Gjallëria e nxjerrë nga zierjet e përzierjet nëpër fortunën e veriut e zjarrin jugor bëhet hise e djersës dhe e gjakut, si produkt i shekujve.

2.

Kur vdiq "RAHMETLIA" lëvizën telat e kurdisur, u çakërdisën çakajt që hanin ç't'u vinte përdorësh dhe lehnin në gjithkënd... ushqehen me hakun e angaries dhe ia këpusin jetën atij që mbahet gjallë me një kore të thatë. Por, me zvoglimin e kafshatës iu sos nafaka të dyve përnjëheri. Leqet gogishte ndërthurren me fijet e zbehta të dashurisë që djeg e freskon, pa vulos besimin e ndërsjellë. Dy zemra të zhgënjyera, ashtu pa prit pa kujtuar u zgjuan, a u shqetësuan!? Më të vetën duarthatë - rropaten që të dyjat.... si pa trup.

Dhe, arbanët e drojtur nga huqet e egra të pushtuesit mbështesin fatin e vet dhe të të bijëve në durimin e qëndrueshëm. Nga hisja e tërësishme zgjodhën urtësinë që mos të bëheshin viktimë e kryqëzatave të ashtuquajtura luftë e shejtë - therrore qytetare. Reja vret si "këput e sos", pa çelur sytë që shkrepin dashuri edhe në mergim. Vallë, a do t'i kthejë bollëku, malli i vendlindjes, apo do t'i përbijë mortja?!

Trualli që na jep sy e krah kishte shumë hise: të ndara, të përziëra dhe, të ruajtura për ardhacakët që i

bien ndesh "fondit të tokës shoqërore", duke lakmuar edhe arën e nënshtëpisë, rrugën dhe ujin - truallin me gjithë tbanë; lirinë, gjuhën e nënës - gjallërinë... Sllavoja, pas sulmit të befasishëm ngjallë panikën e shuarjes "me rrëjë e skajë", ashtu në mënyrë shtazarake. Bën edhe vrasje me zjarr e bajonetë, sopatë, thikë e barot - masakër e dhunë - para syve të prindit; të cilin sprasmi e therë mu në prag të derës, siç mbyllet dera me therrë. Shfren urrejtjen, duke zbatuar qëllimin që do të thotë çfarosje si mjet i dhunës me forcën e ligështisë.

Dhe, shkonin trimat me gjithë familje - Burrat e Kosovës me hallal në gojë dalin nga shtëpia, mbase nuk e dinë kur kthehen... Megjithatë arbanët e vyeshëm i shëmbëlajnë bletës, e përjetojnë vuajtjet e milingonës; shquajnë shkathtësinë e skifterit dhe fluturimin e dallëndyshes që të bëheshin të vyeshëm si bleta: nxirrin përvojën e jetës dhe i mëshojnë praktikës së vet.

Ikin edhe nga liria që nuk është e tillë, veç hibrid me të cilën nuk qitet dorë mbi krye. Edhe pse janë shumicë shkelen pa mëshirë nga thundrat e pushtuesve më mizorë. Përkundrazi shumica jonë e vyeshme i përkushtohet gjallërisë së përfillur nga përtrirja, urtësia dhe puna që i mbanë gjallë. Shtohen bindshëm, por i shiton syri i keq. Nëpër çdo mot i përcillon nga një zjarr ashtu "pa pritë, pa kujtua" dhe, më shpesh u përdhosen trojet.

Mbi ledhet e pashuara ngriten pullazet e reja midis gjelbërimit përreth pemishteve degësh të përkulura nga fryti kalavesh.

Dhe, me të drejtë populli i shumëvuajtur thotë: "Erzlija gjithë i mbetë borxh delengjisë"... Tri të mbathme bëjnë sa një gogishte që mbërthen burrërinë në bigën e mashtrimit, ku shuhet shqip dhe nuk i dhimbet askujt...

- Mos luaj gjugjas bir-o! Se ashtu shpralohet besimi i ndërsjellë, njëra ndër hallkat më vitale të marrëdhënieve ndërnjerëzore, mbase "Burri lidhet për fjale e kau për brinash", kurse luciferri s'kapet për bisht, as për krye; ngulë dhëmbin e qelbur në gojë të shëndoshë... "Gjugjas nuk luhet me hasmin, kur dihet se miqësia nuk qas hilen" thote Gjyshi i sprovuar me gazepe.

Edhe skifteri ka sy të mprehtë, veçohet nga shpendët grabitçarë dhe bën fluturime të hijshme, por rron në shkrepë të braktisur...

- Skifterin gjithë e shiton shigjeta e gjahtarit smirëzi.

- Edhe dallëndyshja si shpend shtegtar merr me vete kujtime të ëmbla, e sjellë mallëngjimin më të përbotur. Dhe, moti i brishtë brenë përtrirjen, në mënyrë që e tashmja shëndetligë rrëzbit qëndresën që e

ardhmja të bëhet më e zymtë; ndërsa sorrat e zeza, pa gajalen e bereqetit rrallojnë misrishten duke bartur kaçelat e zhvoluar...

Nëse lufta e ndyer nuk shndërrohet në mjete paqësore të pleqërishtes që zë vend nuk do të ketë as rregullim shoqëror... marrëdhëniet ndërthurren me befasi të pakëndshme të luftës qytetare. Në të katër çipet e rruzullimit shkelen normat që rregullojnë një hisë të marrëdhënieve ndërnjerëzore, në të cilat veçohet urtësia.

E keqja mbi të gjitha të këqiat terratiset në "mitet mesjetare", herë si hi syve, herë si stoli hyjnore, e varfanjakët ecin zbathur, për të kursyer opingat. Pushtuesi gjuan të marrurit në thumb, mase e quan si të vetën gjithçka zë përfundi. xhinsin tjetërfare e trajton si gjësende të dorës së dytë dhe, sillet ndaj tij si "këput krye e qit në kosh"...

Megjithatë Micanët riprodhojnë hisen jetësore, dhe, Micani laton QYPRINË E KULLËS prej lisit më fisnik që gëdhend sopata.

* * *

Tradita si cilësi e lartë shquan hisen e kulturës, të arsimimit e të vetëdijes, si veçori fisnike micanjane. E Micani kishte hetuar se kundërshtarët nga të cilët dy me krahë e një me bisht lavdëroheshin për vetitë e tyre të rralla: njëri për dinakri dhe tjetri për shkathtësinë e brrylave...

Zonja dhelpër, jo rastësisht vret me bisht të syrit, kurse Skifteri kapërcen disa megja të thyeshme, përreth stroullit të mëshehur në shkrepat e natyrës që e rrethekon. Vetëm gjahtarit të stërvitur, i cili bën syrin shënjestër nuk i shpëton gjë nga thumbi. Mund t'i shkojë huq ndonjë shpend që ndërron stroullin, duke u selitur ku s'e kapë grepi i të mallkuarit. - vërejti Micani dhe vazhdodi: Mos luaj gjugjas bir-o! Mbase pushtuesi ta imponon mentalitetin e tij... kur të biesh në zor "për ta këputur lakun" atë unë nuk e bëjnë çakallët që të lodheshe deri në përshpirtje... "gjugji" lëshohet fluturimthi, por fërfillon edhe në mërgim. Madje i shpërnguluri rënkon... rënkon...

Arbanët, përkundrazi mbështesin shartet e veta në solidaritetin që motivon punën e mbarë dhe shton optimizëm për jetë. Megjithatë kryeshkalle i shiton pushtuesi, nën shkallë u thellohet gremina - reja i vret për së kthjellti, pa forcuar krahët, pa përshëndetur rendin e ri.

3.

Në ngjitjet nëpër një Qafë Mali, për të ngjeshur rrafshin e patrinuar, terthorja tretej në bungajë, e jo në pyellin e paskajshëm. Ne do të ecnim rrugës, nëpër të cilën bartet bereqeti i fushës - kafshata e ekzistencës. Mirëpo, mu para shtegut mështillet lëmshi - bëhet tërkuzë, si mos më keq: varreza të harruara e gurë varri pa mbishkrim radhiten shrrëgull dhe çojnë porosinë e idhtë: mos i lavroni varrezat e lashta që bukës mos t'i vi era mejt.. aty Sulltanit i vriteshin nizamët për një mauzer e dy rrrathë fyshekë; aty Kryekaçaku barte maliher të Junanit e fati i truallit mbështetej në grykë të gacëkeqes.

Pushtuesi çrregjistron kundërshtarët për hisen e shkretë; ushtron keqtrajtimet përbuzëse ndaj arbanëve: në shtëpi, në punë dhe në rrugë... ashtu duarthatë, në protestë, në burg apo në kundërvajtje... vriten me dru, thikë e barot, helmohen si të ishin mi që paralajmërojnë termetin, ose karkaleca që vërshojnë fushën e bereqetit, ndërsa serrat kokrojnë farën para brazës...

Ndiqen arbanët sikur pushtuesin ta drejtonte instinkti, jo arsyeja që dallon njeriun nga shtaza, punëtorin nga paraziti. Madje ç'i duhet bashibuzukut tehu i ligjit - Ligja e ligjave!? Lutjet nuk merren parasyshe e ankesave u paskësh dalur afati... Dikujt, megjithatë ende i shkon kungulli mbi ujë, kurse të pa punët ecin nëpër teh të skamjes, si përkrah varrit të çelur, mbase përfundojnë nga uria vdekjeprurëse. Ajo dhe ata sjellin kolerën "shoqërore", me të cilën s'ka mahi. Ndoshta as qesharakut s'i kërset për qeshjen që i bëhet perde e grisur...

Ligji që mbërthen rrrathët e sundimit, si gaforrja kaçamillin ta gërdisin jetën. Ndërsa të jetosh pa ligje është shrrëgullim i përrjetshëm, kurse po të nxirreshe jashtë ligjit do të ishte njësoj si i vdekur, pa hy në dhe. Megjithatë është ca elastik ligji, për germën e të cilit kapet çatipi që përçon vullnetin e pushtetmbajtësit... i rri në grezë shejtanit, miklon politikaxhitë, të cilëve ua sheh sherrin edhe hyqmeti.

Dhe, rigonte shi me skllotë, mbase në rendin bashibuzukçe arbanëve u nxirreshin nga tri dredhë në kurriz dhe, pa lënduar ligjin Sllavoja mallkon ajamin dhe vetëveten, për një copë tokë, pa frymorë tjetërfare, sikur xhinsin e tij mos ta prekte kolera, nga e cila mund t'i bëhet vonë për fyshekun e vezmes - shpërthen zjarri që ecën...

Të mëdhajt i prananim duke zvogluar veten, ashtu në stuhinë e shekujve. Ende ecim nëpër gjarprij që mëshehin këmbët e qesin kryet, si më ngërdheshje e kërcnime të menjëhershme...

Shihnim vetëm hijen tonë e KORBIN që akuzon arbanët, sikur ata ta kishin hakmarrjen të trashiguar, jo

siç u imponohej e kurdisur mjeshtrisht - ngjitur si me dyllë - për kryet nënsjetull.

Edhe im atë, kur i vinte shpirti në fyt, nxente gacëkeqen... Por, gjente mbështetje në bijtë e fisit dhe gjetkë. Andaj hante arsye: kthehej e dëgjonte kohanikët e urtë, të cilët merrnin një hise të pasojave, në mënyrë që dëmi të ishte më i vogël - barra më e lehtë... ndeshkimi rëndohej - toka nuk e mbanë... Shpirtat e shqetësuar nxisnin tollovinë.

Në tërheqje shihet për ledinë, sikur ne të kishim faj ndiqeshim të fajsuar; detyroheshim gjithashtu të gjallëronim për gazepi dhe të paguanim haraç. - tregonte Gjyshi dhe ngulte këmbë ta dëgjonim.

Mund të vërehet se nga pikat e gjakut nuk bëhet dot kodër, as bjeshkë, mase gjaku merr rrjedhën e fikjes... rritet e bëhet përrua - lumë që rrëmon tatpjetë, por edhe vadit fushën e riton brigjet. Mënershëm derdhet në detin, ku kullandris peshkaqeni që "ka bisht të hijshëm", por ndihet gjallë vetëm në ujin ku noton. Ne përkundër natyrës së bujshme ngrohemi, si rrethekon nëna carrokët, ashtu mrekullueshëm përreth me fushë pjellore, lumej gjarpërorë: brigje e kodra gjelbëroshe; zabele e pyje që s'i çfaros dot sakica mizore: rudina e shtrojera nën kreshtat e maleve të pashkelura, bashkë me plisin e bardhë si bora që zë borën.

Dhe, Korbi që shtrinë flatrat pa kufi, e shumicën e quan pakicë për ta kapërdi pa pardon, i ngjitet përpjetëzës, pa garancë se mund t'i dalë në krye. Mbase çakallët e uritur shnukin xhinsin tjetërfare ashtu për së gjalli.

Dy pika të zeza rrëzbisin njëra tjetrën, mu në vazhdën e rrjedhave të përgjakshme. Kuvendi nxjerrë VENDIMIN që do të shpreh vullnetin e popullit për çështje jetësore, por si do të zbatohet?! Dhe, pyka çanë lisin, sikur prijatarët mos të qanin kokën për hallin, as kërkesat e të nëpërkëmburve. Rotelët në gjirin e pushtuesit rrëmbejnë të drejtën e vetëvendosjes, përdhosin edhe Kuvendin, pa hirin e Vendit, pa gajlen e turpit. Shkyejnë nga një qoshe, si gjymtyrë të ndonjë coftine të harruar në shkrumin e zjarrit që ecën.

Dhe, Korbi si krushk i stolisur me puplat e huazuara nga shpendët cicërrues, ledhatarë, vajtues e grabitës - mishngrënës dhe huqesh tjera mbet i zhveshur... Mbase secili kërkon të vetën... mbërthen uniformën dhe përçon huqet e sunduesit shqyen çka t'i kapë sqepi.

Ndërmjet largësive gjindet shtegu, por fatkeqësisht nëse kërset lufta që çon në çmendirë, shpërngulja del diç si pa bisht, pa krye... rrëzbit unitetin e i jep zemër sundimit të egër që sjellë skamjen dhe shrregullon mirëqenien; shtynë mospërfilljen dhe zbeh forcat prodhuese - fuqinë më produktive... ndrydh motivimin për punë dhe pakson optimizmin për jetë, ashtu "shyt e mbyt" në burgun e popujve.

Zhgardhërohet angazhimi i organizuar e lë ugar arat e bukës; shfaqet epidemia e gllabërimit, pa marrë parasysh hisen e natyrshme - plang e shtëpi të xhinsit tjetërfare. Ndoshta për të ushqyer parazitët - rriçnën e ngulur si nën lëkurë të buallit.

Megjithatë, tërheq gjallëria që pajtohet me vdekjen, por jo edhe me fatin...

Zgjërohet shtegu që tajit ritueshëm, si krater i djersitur, ashtu deri të çelë behari i arbanëve, të cilët depërtojnë, siç thote Gjyshi: "përbirojnë si ndërmjet zjarrit e akullit" dhe, shtrijnë hapin në rrafshlartën, ku përgëzohet dashuria e nënës, urtësia e babait dhe krenaria e të bijëve.

Edhe Sllavoja ndërron një hise të natyrës: "Nëse për çdo vit asimiloj nga një për qint të arbanëve... pas një shekulli... e quaj punë të kryer". Mbase arbanët i përgëzon amshimi: "dyshek toke - jastek guri"!

IV

T Ë R T H O R A Z I

Mahija jote është e vrazhdë për tela të hollë - më kishte thënë Veçili i të mallkuarit që bredhte gjithnjë dhe gjithkund: nën udhë e mbi te; te ura dhe përtej lumit... kishte hyrë në njeriun, i cili nuk dallon kur vjellë vrer, apo thith ngushllim...

Diç më tingëlloi si cingërrimë e xhamit të thyer. Zhagitje nëpër zhavorin që lë treni ndërmjet binarëve... përpjekje për të dalur nga ankthi i mospërfilljes. Pyes vetëvetën, pa pritur përgjegje... vargohen bjerrakohësit, e treni ecën, ecën... Një zë i pa artikuluar, më bën të nënkuptoja se jam gjallë - ai që jam; megjithatë, ardhacaku pa trokitur, pa përshëndoshje ndërhyri: Kafës ia pi edhe telfen, se kam lukth prej llastiku... edhe ata të hyqmetit fryheshin si rrëshiçi, kurse kollankusuri kusuritet nëpër korridore të Kuvendit, si zuzarët mbi cergë, ku lahen duart, si "më rrove, t'rrova e brisku i berberit".

Tërkuza dredhej, si ndërmjet dinakrisë e ankthit. Palët e mllfosura nuk kacafyten, as nuk i bien rrafshit, sidomos ata që nuk e prishin strofullin për "cikrrime"... njëra palë do të thoja kurdis çekërkun e mospërfilljes, ndërsa tjetra fatkeqësisht nuk shihet ai "në shpatullë të pulës"....

Ndërkaq, pushtetmbajtësi të dendurit me dy muaj burg shtëpiak ia falë katër orë, pas intervenimit të dashamirëve... I denduri kërcen prej gëzimit, se katër herë nga një orë mund të dalë përjashta gjatë kohës së vuajtjes edhe pse denimi më lehtë zgjatet...

Në këtë vazhdë, si ndërmjet ëndrrës së ëmbël dhe ankthit të vrazhdë u kisha besuar stinëve të motit, pa ia parë fundin shekullit, mbase VITI I RI s'paskësh qenë i yni!?

Kallzit e mëdhaj të shëndetshëm zor i vret bastra, por reja i shiton që mos të ngazllonin përpjetë. Dikush ndërthurte leqet, e trullanët i mëshonin shytas, s'lenin tromak të merrte musht... Ëndërrtarët flasin për frangjitë e përgjakura - ngujimet e vdekjes - rrethime trefishe të shtërnguara, jo me qoshe guri, as me huj gardhi, veç me hordhitë mercenare të pushtuesve gjakatarë.

Ngrehen kurthat e pabesisë që shitojnë mirëqenien. Sunduesi vret kryengritës e shuan Lëvizjet e zgjimit e të harmonisë, ndërsa fodullët ngrehin rruzat me duart përtace.

- Tjetër hise, as nafakë nuk përfillet kah flitet "gjuha e Zotit"! - u kërcënua Bajlozi.

- Çudi! - thashë vetëmevete... por këmbehen edhe fjalë e sjellje nga më të shëmtuarat.

- "Dashamirët e Zotit" formalisht bëjnë hije përtej gardhit, kurse gjallërojnë me tagrat e

rrumbullaksuara nga djersa e angaries dhe, duke vjelur tepricat pa mund bëhen më të gjtshmit ndër kapisuzët që nuk njohin ligjet e mirëfillta, rregullat e gjuhës, as dashurinë e Nënës që rrethekon carrokët në gjirin e ngrohtë.

Të marrurit në thumb, nga vuajtjet e skamja bëjnë plafin hebe: një hise e urisë u tretet në ankthin e ndërrimit të Qeverive; mallkojnë rahmetin që pik nga ndonjë gjuhe tjetërfare. Hiri i mirësisë, tashmë i takonn Kryengjeshurit që në tollovi han klyshët e vet. Katallani ëndrron ta zgjërojë mbretërinë mbi "tokën e premtuar", xhinsi tjetërfare merr rrugën e mërgimit - mbyll derën me shpinë... "Pazari pa të zotin e shtëpisë" shkakton mosmarrëveshje - kacafytje e përgjakje... shumica e të nëpërkëmburve bëhen hise e rrungajës që then qafën në humnerën e acarit të zi... Në lojën CICMIC të gjorët kërkojnë mëshirën e qiellit, kurse misrishten e zhvolojnë, ashtu pa mëshirshëm korbat e uritur.

- Terthorazi hutaçët bëjnë kumbar mashtruesin që mësheh huqet e gjarpërit nën gëzofin e zonjës dhelpër. E shtijnë në shtëpi, se gjarpëri i shtëpisë nuk kafshon - quhen "Ora e shtëpisë". Andaj nuk bën ta hidhërosh që mos të sjellë ndonjë të keqe, ashtu pa pritë e pa kujtuar. Mund ta ngacmojnë fëmijët që ashtu të pa mbushur sherr do të luanin me te, si me ndonjë lodër të mrekullueshme - përçudshëm - me serrat njeriu që kur të shikon magjeps, kur ecën nuk i shihen këmbët. Andaj të moçmit thonë: "Besnik bënu e besë mos zë"!

* * *

Terthoret janë të vogla, por çojnë kah shtegu i madh, siç ndodhë me asanimet e vogla, ekonominë e vogël dhe, shkollimin e mesëm, ku shquhen tri të vërteta të idhëta. Mbasi nuk kishim KAÇIK për hapa më të pakapshëm asanimet e vogla, përkundër gajleve të mëdha, mundësojnë të kishim shtëpi të shëndetshme, ujë burimit malor dhe, lese për bërlllok; bile të mos dergjej raja nga sëmundjet ngjitëse që sjellin mushkonjat e mizat, ushujzat e gjarpinjt... Mbase vegjëlja në dorë të forcës bëhet cikrrim për kusuritje..

Ekonomitë e vogla do t'i ngjanin pasulës micule, që është e thjeshtë, por nuk bën pa te...

Pas shkollimit fillor ndërrohen PROGRAME, drejtime e kohëzgjatje, por arsimimi zhagitet pa mbështetje për praktikën jetësore. Në rritën më riprodhuese dergjen shtalbat pa hirin e zanatit, pa përshtatjen ndaj moshës, prirjes as llojit të mësimi cilësor për punën që jep fryt, si musht i bimës që lulëzon në hijeshinë e vet...

Për gjithë këto terthorëza, "i pa soji - fukara - kurrkushi" shanë Zotin tim - nalton të vetin e vet ndërshej. Pason mallkimi: mund të bëhet "sundimtar çfarëdo", por njeri kurrën e kurres!

1. Në agun e lirisë

Atë ditë fatbardhë gëzimi e hareje, njerëzit ishin të përmbajtur: nuk kcenin përtpjetë, as nuk lodronin rrafshit. Nuk bënin thëror gjësendi për shpirt, as nuk kishin teprica për shpenzime. Në fytyrat e zymta zbehej edhe shpresa - përgëdhelte dielli që nuk nxenë njësoj - FITORJA i ngjante shkatërrimit e koha brente të vjetrën... ndoshta që t'ia lëshojë vendin të resë!? Por, me vështirësi e vuajtje të pa para, përtpjekjet synonin që të arrihet sa më shumë, me më pak qarje e përçarje.

Strukturat udhëheqëse përcaktuan Platformën e re: Armata muar përsipër rendin dhe mbikëqyrjen. Edhe njerëzit "e besimeve" të ndryshme thirreshin në besimin e ndërsjellë: sillen si "hedh gurin e mësheh dorën"; mbikëqyrësit muarën hisen e përgjegjësisë "përkatëse". Shpresoja se me forca të përbashkëta mund të ndikohej edhe në mjedise të prapambetura, por dukuritë që shuhen në një mënyrë e qesin krye ndryshje brenin "arhivin e prejardhjeve"; urithi çon tokën që vajton për punë - fryhet DOSJA e rrumbullaksuar, si kafshatë e djallit. Dy fjalë "të buta" lëndonin pejzat e acarit - kryeneçësia merr përtpjetë si "ment mbi kapuç".

Te Ura e Gurit, bukuroshe e lashtësisë, shiheshin burra e gra, si kalorës ngadhnjyes. Përballë dhe rreth qosheve të saj zëheshin prita miqësie: kureshtje e dashuri...

Ecim pa vërejtur se Bistrica rrëmonte stomin që t'i ligshtoheshin këmbët Urës, në të djathtë të së cilës një burrë i krrusur, me një copë lëkurë të regjur mbi gjunj arnonte këpucë të vjetra, ashtu strehuar në një arkë ambalazhi.

- Shih, si i konkurron zejtarët kooperues ky "shpirt i imtë" kapitalist - më tha shoku im, si më i kalitur në "luftën e klasave".

- Ndoshta bubërron për ekzistencës!? - ndërhyri tjetri.

M'u pre fryma, hapi më çaloi... Përkujtova shtëpitë, rrugicat dhe urat e shkatërruara nga zjarri i luftës.. Më kaploi një brengosje rrëqethëse dhe plot mëdyshje... Po t'ia rrokullisnim në lumë ato dy tri rraçe... ky farë kapitalisti do të çalonte më keq dhe mund të vajtojë më dhimshëm: nuk tfillon kah shtëpia, por drejtë në Këshillin Popullor të Vendit. Se s'kishte as kasollë për strehim, as kafshatë për carrokë...

- Luje, luje... he, ta luajsha...! - u përzie zëri kundërshtues me zhurmën e kalimtarëve, ashtu në tollovi...

E pava vetën ngusht nga ata sy të zgurdulluar dhe ngërdhucjet fyese që vinin nga tollovia... zhurma ngritej mbi tallaset e Bistricës, ashtu pa fat, pa uzdajë.

Vrapove si ta dija se gracka ishte kurdisur për një tollovi përmasash të hatashme, me pasoja të rënda për qetësinë që na ishte aq e dëshirueshme... u gjinda si në bigë:

- Hëë, mos të luajti çekërku!?

- S'më luajti, veç më krisi "kapaku i kresë"!

- Mjaft keni shty me zort! Tash është liria e popullit...

Këtu më ishte sjellur rrotull gjithçka shihja me sy e më vlonte në tru; i grahja si fidainj i frontit.

Rrahnim gjoks për demokraci, e hallet mykeshin në lëmashkun e nevojave të paplotësuara.

2. Trokitje e trok

Në rrjedhën e ngjarjeve, me bredhje e luhatje, ndërthurret gërshetë ironia e jetës... Daklushi i mëshon troç edhe sikur t'i shkonte kryet rrokotel. Ndërsa Nuni s'brengosej për strehë mbi krye, as për shtrojë nën bri. Ku i shkelë këmba mbijnë lule, e kah i merr mendja zhgrehet një gacëkeqe. Përfton në agun e mëngjesit me vesë, fushës pa metilë e mbrëmjes me xixilloja; shtrinë lozë në "Mrizin e Zanave"...

Daklushi kërkon punë pandërprerë, kurse Nuni papunësinë e e trajton nga aspekti i planifikimit... evidencës. Më të vetën, ofron "mirësi të përzemërt":

- Aksion, aksion... - belbëzoi Nuni, si të vetëquhej aksioon.

- Edhe pse nuk sosen dot hallet, nënqeshja bëhet qesharake...

Çuda kapërthen - katër sy bëhen dy! Si mundet të mos jetë ky provokim flagrant!? - mendon kurrështari dhe vazhdon: mos je ti akçi që bën gjellë të shishsme?!

- Mos të pastë lënë kujtesa, "çajë për fllad"! - urdhëroi Nuni.

- Sa vrerë kam vjellë, sa helm kam ngrënë për këtë pranverë, e zotronte më këshilluake t'i therrja këmbët për fllad që ty mos të bëhej zheg, ndoshta!?

- Ç'melodi!? - disi përqeshi Nuni.

Dhe, çdo gjë trajtohet nga shumë aspekte; dliret në disa shosha, e kullohet në një sitë... veç e di unë një SKAJ të meritueshëm për ty... midis qendrës bën hije, e quhet "etno - logjik! Edhe kështu hulumtimet të flejné në hatër, e hatri shtron kalldramin më soxhade...

- Nuk më përshtaten mua skajet, as qendrat e udhëkryqeve, gropat në to, shpenzimet e udhëtimit, as hamendjet kurrfare...

- Hëë, sa qesharake!

- As nuk do të qeshnim, sikur mbi derën Drejtorit të Byrosë për Punësim të mos bën hije mbishkrimi:
TË PAPUNËVE U NDALOHET HYRJA!

- Ankoju Kuvendi! - porositi Nuni.

- Cilit Kuvend, more?!

Kjo është punë e vogël për Kuvend kishin thënë ata të Zyrës së Vendit, dhe, u drejtua në Pleqësi... Por, ata pleqëronin më të vetën: pa ispatë, pa duagjinj... Megjithatë, pa hirin e Nunit s'ka hajr, as send që sheh dritë...

- Hesht! I ri je dhe, i shëndoshë, si derr... puno! - ia mëtrusi Nuni, sikur ta harronte kumarinë.

- He, dreqi e marrtë! Kush kujt i ka faj, kur asnjëri s'e prekë kryet e vet. Edhe bujqësia e ka me takat... pa almise, pa pleh s'e bën kokrrën e bereqetit... plehu ka hyrë në thes, e ai prej letre... nëse bie shi derdhet, kur kapë zhegu ta zë frymën stërvina. Madje, ku të qas KOMBINATI, të cilin të zgrapcojnë humbjet!? Aty shëgertat bëhen kallfa e disa sish kontrollorë "vetëqeverisës"... Shefat nuk merren me cikrrime.

- Qyshë ashtu? Krejt e ke prishë zemrën.

- Sikur ta kishte përthekuar evidenca hamendjen - do t'i ruaja lopët e fshatit, ndoshta...

- Më vjen keq!

- Mua, përkundrazi diç më mbanë...

- Qyre, qyre! Unë ta tregoj rrugën, e ti bjerrë kohë pas...

Nuni e dinte se "Qengji i butë thith dy nëna" dhe, ia mbante anës kah torishta.

- Nun-o! N'e pastë bërë Zojzi Nikën shëjt, ti po më bën vampir për ta ndjekur qoftlargun...

Nuni hetoi se njeriut mund t'ia pres mendja një gjë fantastike, por edhe të mos ketë haber për cikrrimet që pjellin nga nënçmimi, ndërsa Daklushi ecën, ecën...

Dhe, trokiti. Tri herë trokiti: tak, tak, tak!

Trokiti, si duke u matur, jo për të mos hyrë, por të mos ua prishte ndejën, bisedën, qejfin...

Trokiti...

- Hyr! Ç'po pret?

- Ja, hyra! Mos kujto se do të pendohem... kam pritur katër ditë për të trokitur tri herë që të ndërroj dy fjalë, për një hall, e ti nevrikoosesh pa u përshëndetur!?

3. Pa kohë, vend e emër

1.

Pjella "fatbardhë" ishte nxe në krye dhe shtrinte lozë për të fituar me çdo kusht: për veti si nën droje, brrylas për trashigimtarë. Në shoqërinë shpenzuese pasurohen rotelët, si merr e mos qit...

Dhe, sllavojsit kishin thënë: Emancipimi, për xhinsin tjetërfare, është fjalë e huaj abstrakte dhe, pse mos të punohej si "ngreh e mos këput", në mënyrë që në momentin e duhur t'u kthehej ashtu "këput e sos"!?

Por, ç'po lllomotis?! Në këtë ajam, urithi çon dheun, e nuk dihet a han dhe apo thellon labirithin?

Ndoshta lutet: "Zgjat Zot kësi moti"! Mbase të ardhurat personale shpesh çojnë ferkem kah të paluarat,

tepricat shtohen si shpenzime pa logari...

Lidhjet e ndërlidhjet bëjnë hallkën magjike, siç e don koha dhe vendi. Por, në momentin kritik nafak cubit i vritet ortaku, e të tjerët thonë: ka patur taksirat i gjori; ndërsa, sikur t'iu vriste vëllau - ngushllohet si kurgjë kurkujt - ashtu e ka pasë të shkruar...

Njeriu herak mësynë kah shtegu i dritës, por në vazhden e praktikës jetësore vjen e shpalohej mashtrimi, në mënyrë që i përbetuari pëson të zitë e ullirit... Nxirr brirët shytani që mohon të gjitha të arrirat dhe ato që i ka shfrytëzuar, duke kullandrisur në hisen pa hise: han kafshatën e haramit, e përbuzë krenarinë kombëtare. Duke përdhosur vlerat e larta, martirët e vetëdëshëm e të mashtruar, ashtu pa mëshirë, "pa ujë në sy" vën në peshojë fuqinë e derbeterit për ta bërë burg kolektivitetin njerëzor. Pushtetmbajtësit e plotfuqishëm mbizotërojnë tokë e qiell - dirigjojnë ecuritë e zhvillimit të gjithmbarshëm. E bashibuzukët e paguar për ta ruajtur rendin - luajnë lojën e paparë: Njëri sish shpaloi Flamurin e "ndaluar" mu në dyrekun e Kioskut në brrylin e thyeshëm të rrugicës, nëpër të cilën dilej në rrugën kryesore dhe, iu ngërdhuc Arbërit:

- Pse e ngrite atë simbol të dështuar?

- Që ta shihje sa bukur valvitet në Qytetin e vet!

- Mos u çkallose?! - pa pritur përgjegje një tel i çekërkut të kurdisur bashibuzukçe bëri një si rrotullim: Po, unë i paskëm bërë shërbimin që ai veç e paskësh ëndrruar!?!

Në stuhinë e plasaritjeve të ndërthurrura me përçarje që plasarisin zemrën e shoqërisë, në të cilën ari fisnikron metalet e ngjyrosura, kurse bërlloku rrëzbit pejzat e jetës - i bën paskaj të skamjes që fikë xhinsin dhe trojet pezmaton plasaritjet ndërmjet shfrytëzuesve dhe të të shfrytëzuarve; të angaries e deri te haku sipas efektit të punës... aty pena e hollë me maje shkruan urtësi e nga bishti nxirr flakë.

Gjësendet e nënçmuara selitën në almise të komplikuar, pa njohur teknologjinë, pa çmuar ofertën, mbase humbjet palohen ashtu të bartura prej vitit në vit, për t'u shpërlarë në këmbimin e justifikuar me BILANS.

2.

Ngërthehen spica e kuta në gllavinën e zgardhëruar dhe krijohet pakënaqësi; nuk ka kuvend që i del zot vendit. E vendi i punës shërben sa për të ngulur këmbë si mushku në guri të thatë. Sllavoja ushtron të

folurit e përsosur, si mjet mashtrimi; evidenca justifikon statistikën e dallkauku i siguron shtrojëmbulojë Fodullit që numron rruzat në duart përtaçe. Dallkauku stërhollon telat e shqisave të të dëgjuarit, të shijes dhe, veçanërisht të të nuhaturit... sprovon dhembët si mishngrënës që i mbetet besnik njeriut me serrat të dhelprës e vese të ujkut. Ndërsa ndryshimet atmosferike mëtrashin koren e tokës, si e regjur nga llava e vullkanit. Rriçna zë vend nën lëkurë të buallit; Lëmën e Drithit e çon eskavadori që nxirr xehe nga zemra e tokës e shkelë milingonat që bubrojnë vazhdës së vet... Krijohet ambient i përshtatshëm që të ngritet çardaku si lapidar i varrmihësit. Madje, ndërrohen shartet e kohës, në mënyrë që vendi të vesohet nga rrezet që cingrojnë si dukati në qyp, kurse milingonave u mërdhien krahët në frigoriferin që i flejnë makinat... shërbetorët farkojnë duart, e Shefit të shitjes i shkojnë përdoresh çmimet rrëshqitëse, ku do të thenin qafën dertëlitë e periudhës kalimtare.

Nëpërgojzat që pjellin sherr, përçka mund të bëhen kërkime edhe jashtë hamendjes, ia shnohin zemrën vendit që i del zot kuvendi; pakënaqësia befason "prite Zot" nëse ndodhë ndonjë çrregullim i pa pritur, siç edhe fshisa çon pluhur, por dliir bërllok...

Andaj ka rëndësi të veçantë thënia popullore: "Guri i rëndë në vend të vet"!

3.

Nën retë e qiellit të zgjebosur, mbi truallin e begatshëm kaluroon sugari që thith dy nëna; bollëku lëshon lozë sikur bima në bagël, pa gajlën e vadës, pa hirin e diellit. Ecën tërthorazi për t'i kryqëzuar këmbët në tregun e zarzavateve që të mos kthehej duarthatë në strofullin e mykur nga cikrrimet që tajisin si dergjë e pashërueshme; ndërsa klyshi i gjetur selitet në "vigjilencën shoqërore" e klluqet në "fondin e tokës së premtuar". As punonjësit nuk e humbin pusullën shqim... mbase organizatave punuese u rekomandohet: t'i frenojnë çmimet deri të hartohen KRITERET për formimin e tregut, ku të harmonizoheshin marrëveshjet, sipas dispozitave në fuqi...

Në surratin e Fodullit megjithatë shfaqen lisha që bulzojnë nga ethet e pasurimit me çdo kusht. Besimtarët lutën për bereqet, thiu bën rrëmujë kallamoqin; spekulantët e stolisur me ngjyrat e ylberit mërrroten më erë të luleve dhe i bëhen këmishë zengjinit të ri. Punëtorët e angaries ngjyjnë kafshatën e thatë në yndyrën e hidhërimit. Krijohet psikozë dyshimi e mospërfillje: humbin ata që harrojnë emrin e vet e kapërdisen si gjeli maje plehut. Tollovi, në të cilën gjjumashët, indiferentët dhe injorantët çojnë ujë në mullirin e dushmanit.

Një hise e dukurive baksuze nuk merren në thumb që të mos i çohet lemza atij që ka mizën mbas veshit, kurse të dytat vadisin deri të mbijë "orizi i idhtë" në plantazhet e kërkesave pa ofertë...

Koxhabashi i mëshon si "këput e mos sos", mbase shpenzuesi nuk mund të bëhet lypës edhe krenar, sidomos në kushtet modeste të mirëqenies, ku malli mykej e oferta prente para. Arsyen e lustron tatimqarkullimi, pa të cilin nuk do të kishte pushtet, as pushtetmbajtës të gjatshëm. Ata pasi e bëjnë bërlllok aty ku shkryhen e shkëpurdhin - kthehen e kërkojnë ndihmën e "faktorit shoqëror"... me shpresë se dikushi do t'i binte samarit që të merrte vesh kali.

Krraba rrin e ngulur në sanë, kurse grabuja nerzehej me tërfurkun, e pjella dilte pa perde në sy, pa qime në gjuhë. Merr krye nëpërkëmbja... dhuna i qepet truallit, sikur të ishte kallamishte, ku secili mund të nxirr sheqer të papërpunuar, ashtu pa kohë, vend e emër.

4. Fatkeqësi intime

1.

Ja mëtrusi frejtë, sikur qoftlargo t'i kishte dalur para rrotëve që rrokulliseshin binarëve, duke përshkuar rrugën, përballë së cilës sosej horizonti midis rrafshit. Nga dritaret e vagonave "kurbani" shikonte fushën që përfton si rrëshqitëz nën këmbët e palara. Shpejtësia, si të thuash, ia kalonte zërit të shukatur në krahërorin e ndrydhur, e treni trettej në terrin e asaj dite të zymtë.

Udhëtarët ecnin mbi rrota, por përçuesi nuk përfillte spicat që lidhen me kuta, veç pykën që çanë gllavinën. Mbase njerëzit nuk ishin njësoj, as interesat të harmonizuara me ujdi...

Përpëlitesha pa gëzuar jetën, kuptimin e së cilës e humba bashkë me vetëdijen, kurse përçuesi sapo hetoi vdekjen u largua, sikur ta kishte rrokur "puna e trollit". Më kishte ndrydhur shtrati i epërm, i cili u zhgreh mbi mua, siç shkoqet stomi nga bregu i rrëmihur... Kllapia më bëhet si hije e vdekjes; dhëmbjet më shkaktonin njëfarë krize, e ajo më luhaste në kolovajzën e mëdyshjeve: me një sy shikoja dy sende, e me të dy asgjë!?

Treni i afrohej tunelit të skajshëm - fishkllloi melodinë monotone, pa hirin e udhëtarëve, pa mëshirë ndaj të lënduarit - Vrapin rrëshqitës e ndërpreu frenimi zgrabitës, për sherr të të cilit u këputën hallkat,

shtrati i sipërm përplasat mbi kurrizin e lodhur. Më bëhej sikur të isha plandosur diku në fund të greminës, pa i dhënë dum arsyes.

- Eh, ti jaran! Pa të shkuar lëng për gojë nuk belbëzohet për gjëra të uthulluara...

- Tjetër herë pusho mbi rrotë që ecin përtokë, ose përshëndoshe "përjetësinë"! - kishte folur dikush për... e dikushi kishte ulur kryet mos... të tjerët kishin këshilluar, si tym për shtëpi e qejf për njeri... siç shtrohet rruga me asfalt të butë, për thundra të qëndrueshme. Mbase fatkeqësitë e komunikacionit fabrikonjë edhe lëndime misterioze, mëvarësisht nga mekanizmet e kurdisura, ashtu përdreq...

2.

Ecte treni i udhëtarëve çkujdesur... përshkonte hekurudhën, për të plotësuar nevojat e qytetarëve, ashtu i motorizuar. Por, përçohej nga hutaçi që gjithë kujdesin ua kishte besuar binarëve, sikur mos të kishte krye, as timon. Dhe, qytetarët udhëtonin pa gajle se trenit i lidhej kryet me kujdes të dorës së dytë, mbase mekanizmeve të çelikut nuk u nevojiten pjesë të brumit tjetërfare.

Dhe, mjeku kryesor më vizitoi, sikur të hulumtonte diçka duke trokitur mbi shtyllën kurrizore, e mua më qitnin sytë gaca. Sikur të kujisja nga dhëmbjet do të më quanin minak... Por, shih si keqpërdoret njeriu në gjumë dhe, pa faj, pa borxh"!

- Këtij nuk i dilet hakut, pa ia ngulur dy kryqa mbi krye: një të kuq e një të zi...

- Lëndimi nuk është as mallëngjyes, mbase edhe "mjeku" shëron me duar dhe me zemër.

Në ironinë e tehut ku ndahet jeta nga vdekja i lënduari mund ta kërkojë vdekjen në vend të ilaçit... sidomos kur lëndimi është i natyrës që mund të çojë në harresë.

3.

Në Dhomën e Kurës Intenzive, ku shërohesha përdoren vetëm tri ilaçe: glykozë, gjak dhe arkivol.

Kështu e kishte jeta nën kujdesjen e spitalit, sidomos kur zbatohet kura intenzive, pa të keqën e

papërgjegjesisë. E, mua tri herë më ishin errësuar sytë, si para vdekjes. Dhe, aq herë vetmohueshëm kisha përballuar valët e jetës së bujshme.

Iu përfala luftës për çlirimin kombëtar e social... mora frymë me sy kah horizonti i poopujve të vegjël. Por, në gjysmë të rrugës më kapluan këmishazitë dhe, me pranga në duar më çuan fill e në Trup - rojë... Shefi urdhëroi: çojeni... mora plaçkat, por bërtiti duke sharë me nënë e baba dhe shtoi: "T'ma kishin lënë dyshekun në burg Musolinit ia kisha... nënën! Vija" - m'u ngërmua mua dhe Rojes...

Roja mori qëndrim gaditu... urdhëroi: Përpara! - dola në oborr, por ç'të shihja!? Një dhjetëshe ushtarësh me bajoneta të mbërthyer, mu para murit, ku pushkatoheshin bijtë e bijat e popullit lirishtës ushtroheshin. Si t'më ngujohej truri... nuk pata kohë të përkujoja gjë më shumë se vdekjen. Por, në krahun e djathtë, shkallët çonin në nëntokën e njëj përdheseje me pesë biruca që quheshin "çelitë e banditëve", njëra ndër të cilat më ra hise, si shpërblim për rrugën që isha përcaktuar...

Herën e dytë, aty kah zemra e Kryeqendrës së Vendit në Qytetin e Bardhë, ndërsa bëja përpjekje për strehë dhe ndonjë makinë për Shtypshkronjën e Prishtinës, një kamjon shumë-tonësh që kalonte aty pari, ma bën fuzë një guri rrumbullak, i cili ashtu rrufeshëm vret në murin kundruall për skaj tamthit e më shurdhon nga një fërshkllimë trishtuese. Për pak që s'më fshiu mortja, pa shënjë, pa dokë.

Dhe, ja kjo ndërshejzë u bë shkas të nxirr në shesh dy të parat, pa u frikësuar ç'më gjeti, pa gëzim që shpëtova...

Fatkeqësisht, u çakërdis qoftlargo që rritet si shtogu në pleh... pasojat marrin krye me leqe nëpër këmbë.

Dola nga sandeku, në mënyrë të përçudshme dhe pasqarueshëm... Por, ime shoqe që më shërbeu aq shumë dhe me aq kujdes, ende "qanë e qeshë".

5. Krrabëz për vegëza

1.

Higjenizimi dhe asanimet - probleme të ngatrrura dhe marrëdhënie marramenthe rrokoteleshin duke ndërruar vendin: herë të parat në të dytin, e herë të tretat në të parin dhe anasjelltas... Shefat premtinin

ndryshime të reja, kurse Kryeshefi i grahte më të vetën - të vjetrën. Vendbanimit që zgjohej heret e rindërtohej për gazepi i kanosej derxha: tuberkuloza, tifoja e zorrëve, zgjebja - më banalja ndër të tjerat, të cilat nuk njohin farë e fis, burrëri, megjë, as pajtim jashtë ilaçit përkatës... Si dukuri të pakëndshme prishi disponimin e atyre që rrethekojnë torishtën, por nuk dlinin bërllokun.

Kushtet jetësore në shoqërinë sa për sy e faqe nuk kullonin musht, si në kopshtin e babait, as kakiçkat e mbivadës nuk rriteshin si shtogu në pleh; rahmeti nuk pikte nga qielli, as bereqeti nuk gufoi bujshëm, si në ajamin e motit të ri. Takati ishte i hollë, e socializmi matet me takat...

- Nuk bën të ëndrosh tejkalimin e vështirësive, pa mënjanim të huqeve vetëjake, mbase duke nxjerrur dredhë në kurriz të tjetrit, vjen e mëtrashet zullumi që varfëron kuptimin e jetës - çeli bisedën
Kryesuesi:

- As rinia nuk i është përveshur pahiri transformimit të midisit jetësor. - miratoi Mikel doktori dhe shtoi: Bërlloku ushqen mjerimin, e punës i bishtërohet në hesap të shoqërisë që paguan haraç për "ment mbi kapuç"...

- Uh, uh të pastë halla! Neve na mbyti hasallëku, e ti po dashke me na pru në vetel?

- Hë, de! - belbëzoi njëri.

- Më mirë do të ishte ta rrafshoni kalldramin - xhaden, se sa të çoni pluhur çorrsokakut... - këshilloi vozitësi, të cilit veç që s'i kishin mbetur rrotët e kerrit në gropat e rrugës.

- Fatkeqësisht, interesat e qytetarëve po shkapërderdhen, si "tym për shtëpi e qejf për njeri". Por, as kështu nuk bën. Diçka po e pengon edhe pastërtinë, shëndetin dhe nafakën. - vërejti Kryesuesi.

- Po more, qysh jo! Tash që kemi bërllok edhe për të gjuajtur mund të na ketë ajam edhe ujdia... pastaj ambientin do ta mbulojë gjelbërimi; arat do të vaditen me vesën e agut, e punonjësit nuk do të bënin angarie...

- Mëtrus, ti! Prej kah na dole, të na mësosh si të jetojmë, kurse vetë po ngjesh tanë këtë lloq!?

- Gjithmonë e kemi pasur kështu, edhe tash mund ta shtyjme disi.

- Çka po u duhen nevojtoret tona?!

- Ndoshta do t'u ndërtojnë nevojtores edhe kafshëve, se i kanë përzanë nga shehri. - ngacmoi dikushi, që ia ndrron gurët djallit.

-Ju bëni ç'të doni, veç kush prek në megjë time, le ta merr qefinin me veti! - u kërcnua njëri që kishte qit sytë në kodër.

- Edhe ju si të doni, por arsimimit shëndetësor duhet t'i paraprijë AKSIONI i higjienizimit... - porositi Mikel doktori.

Luhej njëfarë urtësie, si të dukej se dikush po kujdeset edhe për zhdukjen e prapambeturisë. Ndërsa midisi jetësor dergjej në pluhurin e skamjes që sjellë fikjen. Ekipet e sanitetit do të ndërmerrnin diç që mos t'i vi era bërlllok, as përtaci, kur është fjala të ruhet e të përparohet pastërtia e midisit jetësor dhe shëndeti i popullsisë përgjithësisht...

Më lehtë dhe më lirë, si prapavi e një të panjohure, do të shndërrohej mirësia me asanimet e vogla rreth pastrimit dhe rregullimit të nevojtove, shtallave e sjolleve, ku mblidhen mizat si në grubull të plehut. Edhe kjo farë veprimtarie çonte puhinë kah zhurmimi i përpjekjeve për bukë goje, ujë shëndeti dhe dritë... këtu nuk ka tumirë, pa përmirësimin e gjendjes, pa ambient të shëndoshë.

2.

Ekipi i sanitetit pushonte; gazika nuk zukati atyre tërthoreve, as fshati nuk u shpërpush. Mbretëronte njëfarë shkujdesje mallëngjyese si ndrydhje nga përtesa. Ndërsa Halla Mejreme - Gjyshja fisnike do t'i qëndronte dhëmbjes së dhëmbit që e ngushtoi, si të vdiste, mu në kohën që s'kishte mëshirë ndaj të zhgardhëruarëve.

- Dhëmbi i prishur qelb gojën. - ndërhyri Mumini.

- Edhe trutë e uthulluara kalbin kryekungujt. - mallkoi Halla.

- Aa, Hallë! Shkele rëndë...

- Kaherë m'u kishte rjepur qafa mos ta kisha truar hostenin!

- Ku dreqin i gjenë këto dokrra që gjuhën ta bëjnë krrabëz e fjalët vegëza!?

U ngrys pa shpresë se do të gëdhihej. Buzët i plasën nga shkrumi, e nofullat i ishin kallur më pezmatim... I shkoi mendja të kërkonte ndihmë mjekësore, por doktorin e kishte rënduar. Shpresonte, në mos tjetër, se nipi do ta çonte në Ambulancë, por as atij nuk i pat lënë gjë mangut. Përkujtoi edhe

voztësin - shakirin e shehrit që i shtihej si qoftalargu, e kalamarëve nuk u besonte. Përkujtoi Muminin, por sa pare bën!? Ai s'e ngjiste çejzën pa zor, e Halla nuk i përshpirtej. Nuk e nënçmonte maminë, por s'e kishte ndërmend "të pjellte". As motrën patroneshë nuk e harroi. Iu ngërdhuc nipit:

- Çou, bre kishk! Kudra me pasë kujis kaq... ish dashtë me të dalë, jo gjumi po tamthat që t'u kanë fry si bulshi zurlaxhie. Shko... te milicia... Hë! - tha vetëmevete, kur të marrin vesh... thonë, le të mundohet shtriga, se na ka pru shpirtin në fyt! Le të cofë, se s'ka kush na kthen fjalën, as kush u jep krye katundarëve për së prapështi... "Ka dekë prej exheli" thonë, e kurrkujt kurr gjë. Edhe një lugë më pak... Ata thilera as mahinë s'e njohin për mahi; kur i rrenë të zënë besë e kur u tregon drejtë kërkojnë dishmitarë... Por, hiqna Zot qafe qoftalargun! Edhe ndër ta ka të mirë. Sa herë e kanë thirrë spitalin për kryethyemtë ndërmjetveti... e pse mos të gjegjen edhe për mua!? Therrë në këmbë prej meje s'u ka hy... Aludoi e gjëmoi Halla mëvete, por dhëmbja i shtohet më rëndë dhe më gjatë se rruga në drejtim të qytetit.

* * *

Hyn në Ambulancën e Dhëmbëve që shkëlqente si rrezja. E rrethekuan medicinarët. E ajo s'dinte ku gjëndeje!?

- Dhëmbët-a? - tha Dentisti kujdestar.

- Dhëmbët... ndoshta!? - murmuroi Halla.

- Cili?

- Çka, cili?

- Dhëmbi, ndoshta, jo këmba...

- Hëëë! Ku ta di unë... në ketë siklet? Gjëje ti... pse je doktor?! - injoroi Halla.

- Hape gojën! ... ashtu, ashtu... mbështete kryet! - urdhëroi doktori.

- Hape derën, se m'u zu fryma! - bërtiti Halla.

- Mbajani duart!

- Kujt bre, me ia mbajt duart, për një zgrapcan dhëmbi?! A je në veti? Nuk e njihke hallën Mejreme!
Kur...

- Mirë, mirë! Të kryejmë punë... Dhe, sa çel e mbyll sytë, një rënjë dhëmbi doli nga vendi, u gjuajt në shportën e mbeturirave.

- Po, ti ma nxorre të shëndoshin, bre qafir! - u ngrit në këmbë dhe iu drejtua të nipit: Të kthehem...

- Por, me çka? Makina e milicisë kishte edhe punë të tjera...

- Qyshë jo! Ata i kryejnë ka dy punë përnjëheri... dhe, vetëm çojnë... me krthye s'dinë...

Ndërkaq nipi, për fat të mirë gjeti Muminin që kalin e çejzën i mbante për merak... ai "shërbente" në raste të jashtëzakonshme...

Diçka krisi, krisi, jo si vret rrufeja, vëç si terr syshë, a rropamë rrotësh, a hingllimë kali!?

3.

Zhurma shurdhuese e Gazikës që rrëshqiste në baltë e gjëmonte si thirrje kushtrimi kumboi fshatit.
Ekipi i asanimit, në krye me Mikel doktorin zgjoi fshatin...

Fshatarët u dolën përpara dhe i pritën me dorë në zemër.

Doli edhe Halla. Doli nga Porta që rraploi si të hapej shpella nga zemra e shkëmbit. Doli një plakë zeshkane e hollë dhe e gjatë, si krrabë sane; krrusur nga koha, e vrërët në fytyrën me eshtra të gjërë, me sytë që fshehin zinë e kohës së zyrtë, nën vetullat e përhimta, si megjë therrash të kërleshta.

Doli edhe Salihu, nipi i Hallës, njëfarë mamrruku si trung rrapit me një shikim si të stërvitur për kacafytje. Përbiroi nga porta si fërshkllon murlani për të hyrë brenda.

- Ku je nis bir-o? - ngacmoi Halla.

- Qe, po na thrrasin... për punë të fshatit.

- Për punë të katundit-a!?

- Po, për punë... për të mirën tonë...

- Hë, se të vetat i kanë bo fet, e u paska dalë rend të kujdesën edhe për tonat!?! Por, kqyr nan-o! Se, ata që nuk kanë fshi oborrin e vet nuk kanë kerr për bërlllok të katundit. Bungajë ashtë kjo virane. Kqyr se bohesh argat i dreqit, se s'ka shi që të lanë... t'merr pusi!

Ndërkaq arriti edhe Xha Mumini, halabaku i fshatit, të cilin ende nuk e kanë lënë sytë, por i është topitur të nuhaturit, ndërsa strofulli, si shpirti i është mykur. Përmallshëm u përshëndet me hallën. U ul pranë portës, mbi gurin që po të fliste nuk do të na binte hise të ndëthurnim këtë tregimth.

Ekipi i sanitetit u drejtua kah shkolla, ndërsa vozitësi skajoi Gazikën dhe u ndal para portës. U ul në gurin kundruell me Hallën që s'e kishte ndërmend të pres, as të qes... u përshëndetën, si përvjedhtas duke u shikuar brijas...

- Në Qafë të Malit, atje prej kah shihet fshati, mu në mes të rrugës, pasi u rrëfeve tri herë para vetës, me dorën time ngula thikën kryq që mos të bjer më pikë shiu kah merr ana e këtij fshati...

- Dora jote t'i nxjerrtë të dy kokrrat e syve, he thi! Uh, thika t'u boftë kryq mbi rrasë të vorrit, he qafir! Pëhu!

- Ngul, ngul...

- Ku me ngul dhe he shkulan! E, mos raftë shi?! Çka e lanë tanë këtë bërlllok? Ekipi jot, as ti, as Zojushat e sanitetit s'e lagun vangun e opingës për atë zanat. Duart i ferkojnë me lang që ta bojnë spital kah të shohin sytë. Ktheu e nxirre atë thikë ndjellakeqe... kjo lograçë që shkund hinin e saçit, mundet edhe pluhur me shkund. A more vesh? A po pret ditë më të mira!?

- Oh, luaje hallë, luaje...

- Uh, uh! Fëllanza e nanës, ti nuk paske nevojë me t'i përkëthye doktori fjalët! Po i grahke si laroji që ngjitet në të dy krahët!?

- Hallë! Mos na nguc Vozitësisn...

- Jo, nano! Ka halla aq men. Qysh t'ua nguc atë që ju çon në rrotë të huaja dhe, nuk ua lën kopilin te dera?!?

- He, ç'na polli mushka!... para këtyre dyerve!

- Dyerët nuk të kanë faj, lum loci! Por....

- Por, ata që kanë ardhë për pastërti...

- Kujt t'ia nxen rrugën bërlloku le t'i shtrëngojë praqet për lese! Çka më han palla mua, se kush i bjen kryq e tërthor katundit: kush thirret a përcillet, me sofër të shtrueme, a me strajcë kraeqafë, te nuni a te nriklla, para Kische, a te Xhamia, në Odë të burrave, a nën Bli... mua as nuk po më qajnë fëmijët, as nuse nuk kam për mexhlis. Por, Sefës i ka vdekë nusja, se iu kanë rrotullue bineqët tërthor, e i ka dalë shpirti për adalet. Muratit ia ka rras kuqoi brinin në mullë e ia ka qitë zorrët në ledinë, pa ia pasë mbledhë kush, se me ia pasë lidhë doktori, as nuk ishte vajtue aq përmallshëm. Metës i ka dalë "e dala", e Rasimit i bjen lëkura në tokë se ka kush ia ngjet dorën. Por edhe kësaj i gjindet ilaçi.

* * *

Ç'njerëz të djallëzuar!? I mëshojnë çykë sakice që të ngulet pyka më lehtë... kur nuk na kaplon puna - nuk i sheh dot, kurse në valë të punës vinë me stërpikë miza e pleshta... hallakatin birë për birë, qesin nga një grusht shkumë në pus, e m'i shkelin edhe ato dy lozë kungulli e tre-katër tranguj n'lulë. Na flasin për do rregulla, e vetë i mëshojnë shrregull, si të lodronte dreqi nëpër oborr... Fundja, t'i lëm hajgaret... cili ashtë doktori?

- Unë, vetë...

- Uh, unë e zeza, krejt qenkna koritë... edhe ju ini përdreq... Çfar doktori, pa nishana, pa i zgjedh fjalët!?

- Jo, jo s'ka gajle, veç çfarë halli pate?

- Për shkurt e trup s'kische bo keq m'e kqyrë pakëz ketë Nipin tem; mos i mungon ndonji drrasë e kapakat të kresë, se bukur shytas po i mëshon tollovisë!?

- Për kah goja e dora është në rregull. E pash atje në aksion. Të tjerat janë cikrrime... por ç't'i bëjsh pleqërisë!?

- Eh, u plakësh me lese në dorë!

Shoferi kapi timonin, ndonëse i pritonte rrugës pa rrugë, në të cilën hoqi të zitë e ullirit. Sa ndërronte marshat, aq frenonte me këmbë e dorë, me dhëmbë të shtërnguar. I grahte duke kënduar vajtueshëm: herë shante çka i vinte në gojë, e herë ofshante sikur mos t'i kishte mbetur gjë pas shpirtit.

6. Ngushllim

Ylberi harkohej si në "shi e diell", siç lahen shtojzovallet, e moti i ndryshueshëm paralajmëronte të reshura me shtrëngatë. Natyra e egër çëron hesapet me të mjerët që s'mund të rrumbullakosin asgjë para se të sulmojnë bashibuzukët...

Edhe Hallën Mejreme e kishin zën ethet e dekës. Dashamirët vargoheshin vi e vistër, për t'i bërë vizitën e hallallit. Tashmë, s'kishte mbetur për fjalët kokërr, as për kokrrën mbi kapuç. Zoja e shtëpisë kishte shtruar postahin e oqiçit në markëzen e vogël të Odës së burrave... Merrte hallallin bija e fisit, mbas së cilës do të fikej Konaku.

- Dua t'ju shoh për së gjalli, se në dekë nuk e di kush më knon rahmet, a kush ma truan shpirtin!? - përshëndoshi Halla.

- Qëndro, hallë! - desht ta ngushllojë Mumini.

- Qyre, qyre! Edhe Mumini paska ardhë!? Ndoshta për hallall... Po, ku e ke harapin? Atë klyshin... "të gjetur në zabel" ... thojshë ashtë zog ujku... me qime të zezë!?

- S'po më kujtohet! Shumë ujë ka mali, e shumë ujë kalon nën urë... - do të humbëte ferkem Mumini.

- Uji shkon nën urë Mumin-o! Po marrja mbetet...

Mumini nuk u çudit, por u ofendua rëndë. Ndërroi vend, e kafen e cigaret i la në cergë. U krijua njëfarë situatë, si murmurimë e nënqeshje ë përnjëhershme. Plasi një shushuritje, si të rigonte shi i Majit - dukat për gjelbërim...

Mu në atë çast hyjnë një "teste fëmijë të fshatit...

- Hajdeni, hajdeni pëllumbat e hallës!

- Qoftë e shkuar! - uroi i pari dhe i ofroi një kokërr hudhër; pakëz uthull ia dhanë dy të tjerë; ja edhe pak kos... një trangull e dy domate; tre-katër specë djegës e një kaçile kumbulla bordalike; dytri kokrra dardha të dugëta, do vojsa e pak manaferra... patate e bishtaja... më pak sende me shumë hijeshi përzier me mallëngjim.

Vashat, si nikoçire kishin sjellur një deng fier të njomë dhe një shportëz dredhëza që mbushën

dhomën aromë e Halla nënqeshte zbehtë, si kandil që shkrihej në dyllë të vet.

Voglushët shpreheshin hareshëm, e sytë u vezullonin si xixillonjat në grunajë. Ndërsa Mumini mbeti si i gozhduar...

- Çohi burra! Të shkojmë, se dreqi s'e han ketë shtrigë...

- Ne nuk hidhëruam askend! - vërejtji njëri nga voglushët.

- Jo, lum Halla... Mumini me çakajtë e klyshin "kimezi" janë idhnakë... hajnë hardhuca e pjellin çapina. Mbase klyshë e langoj ka shumë... dhe, asish që kalurohen me bisha të malit. Edhe "harapin" si klysh trupullak e mbanë Mumini dhe krenohet se ashtë e sojit të pashoq... por na nxori punë... mësynte herë një pulë, herë një macë e herë-herë ndonjë qen rrugaç... mandej i lëshoheshin të tjerët - haheshin ndërmjetveti. Ky ikte e të zotët shtyheshin brijas...

- Si mos të kishin tjetër gajle!?

- Çohi, voglushët e hallës! He, lum Halla për ju! Çohi, mos rrini rahat, ngani e theni, derdhni; shkyeni e coptoni. Veshuni mirë e më mirë, edhe keq, si t'ju pëlqejë... këndonni e gëzohi... Tjetërkushi ia ka bënë mundin e zuzarët shkryhen - shkryhi edhe ju! Çka të leni pas veti e ndreqin të tjerët...

Edhe shesin fall, se shtrigat nuk i kanë shtalbat e vet!?

* * *

Tërthorja tërhiqte kah shtegu, e qeniet tjetërfare kishin lënë gjurmët e veta. dhe, secili që ecën në dy këmbë e përfillet me një krye gjënë mënyrën, kohën dhe rrugën e gjallërisë; nxiton të kapë një hise të hapsirës së mundshme të quajtur natyrë, ku mund të krijojë fatin dhe hisen përkatëse.

Dhe, Mumini më një aheng, pa Darkë Lëme, pa SYNETI gostiti me një bisht dashi, dy-tri kokrra vezë pule dhe një varg specë dikend - dikund - përreth Bjeshkëve të Nemuna. Aty gjelbëron bari e bora zë borën... gurgullojnë currilat lëng bore. Puhia përshkon shtrojerën... Megjithatë nga zullumi mëtrashet lëmashku i veriut e teret pluhuri i jugut. Dhuna rëndon zgjedhën... e skamja sjellë mjerim. Dikushi lutet: "Zgjat Zot kësi moti"!

Edhe Halla shkrep të shkretën: mëpreh krrabëza e thurr vegëza...

Ngushllimi i ngjanë përgëdheljes që ndërthurret si "shpërblim për mirënjohje". Ndërsa rotelët zhagiten, si në vazhdën e kaçamillit, reja shiton ashtu pamëshirshëm, kurse tanët Kollin e Keq e quajnë "koll i mirë"!?

E, Mumin zuzari bën shpenzime pa haraç - batallis Kuvendin që han arsye dhe don t'ia thith mushtin trandofillit, në vend të kakiçkave të mbivadës...

Ngushllime!

7. Nënflëtë gjuhësh të nëpërgojura

Natyra e trojeve tona dhe karakteri i të bijëve ballëhapur nxisin nisjativë, praktikë dhe synime kah shtegu i dritës - bëjnë vazhdën ndjellmirë që ushtron gjuhën e mirëkuptimit në shiritin gjeografik, ku do të bëhej masakra më tragjike ndaj të nënshtruarve, sikur të ishin miraz pa trashigimi.

Dhe, Sllavoja kishte mësuar "hinglisht", por në përplasje me gjuhën e egërsisë "u bë anglez". Vërejti se në tehun e mosmarrëveshjeve gjuha e çakallit, a e dhelpëres... mund të kuptohet sipas veseve. Përkundrazi gjuha e arsyes ndanë e bashkon, hijeshon dhe i jep kuptim jetës edhe në të shkruar, ku pika prenë shkurt e trup.

Megjithatë, në gjuhën e popullit, ku përmendet emri - zëri i zuzarit, ndërrojnë raportet: çon krye kurrështja, smira, inati... zën fill ndarja - përcaktimi formal. Populli don ta di kush me kend është që të përforcojë aminin. Mirëpo, "Ora" që përçon idenë dhe ideologjinë - interesin dhe fitimin - parillëkun shiblohet e kullandriset në logari të atyre që paguejnë haraçin. Ndërthurren leqet e mashtrimit, si stoli të rralla gjuhësh të nëpërgojura.

Ujku që ka dhëmbë të mprehtë e durim kurrfare do të bënte marrëveshje për ta prishur ujdinë me veshëgjatin shkurtpamës. Por, nëse i rraset ngojë trullanit, do t'ia fshijë dhëmbët, mbase edhe kështu, kur është në ankth lyp "një therrë m'e lag gojën"...

Gjithashtu lejleku si "shpend i shejtë", sipas simpatisë së "besimtarëve" merr uratën dhe, vëndin për çerdhe, pa peshuar dhimtën, pa gajlën e dëmit. Shtegtari i veçuar, për hir të iluzioneve ngreh çerdhën mbi OXHAKUN E FIKUR, ose gjetkë... e mbushë me glacë - e bën lejlek - ta lëshojë, ose të ngordhë në pleh të vet.

Edhe zonja dhel për që vret me çepalle do t'i tregojë lejlekut se Veçili që nxirr dredhë për gogishte, duke mëltnuar vullnetin e Padronit ndërthurrë leqet e përçarjes... dhe, Junanosi u bë zagat... kapi dhel përën për këmbë, e SKILJA e vjetër përqeshi tinzakun: He, i giorë! Në vend të këmbës ke kapur rrënjën.... diç mbeti peng...

Peshku shtohet në ujë, por nëse noton në të turbullt e hanë, jo peshkaqenët, veç bretkosat.

Mbase blea kullotë gjithkah, por nuk helmohet - mbledhë nektarin dhe bën mjaltin që përdoret edhe si ilaç...

Në kushte të jashtëzakonshme - kush e di çka do të quhej normale!? Urtësia popullore megjithatë kultivon durimin për derisa të rritet fryti i quajtur besim i ndërsjellë që do të luante rolin e vet të merituar.

Vetë preku këmbën - imja është; fërkoj duart - të mijat janë dhe, trupi im në mjedis të vet. He, dreqi e marrtë! Edhe ai kishte marrur hisen e vet, por s'kishte STRAJCË ta barte Tempullin, as Bjeshkët e Nemura...

Ndërkaq, nënflata merr krahët e bletës; kallinjët kalaveshë zënë kokërr - bima e truallit micanjan begaton sofrën që shtrohet me dorë në zemër.

Dhe, Micani don që i biri t'i rritet diku më lart se ai vet, por bën dua: "Rujna Zot prej zengjinit të ri"!

HAKU NË HAK, RRAHU NË MAL TË SHTETIT

1.

Dimri me një hise bërlloku që mëshehet nën plafin e bardhë, këmbë pas këmbe, si me pritesë shndërrohej në pranverë. Ndihej cicërrima e zogjve. Gjelbërimi mugullon. Edhe prozimit nuk i ndahej zullumi; rrallohej si ta vriste gucimaca. Secilit i vinte keq; secili, rreth shtëpisë kaçubën do ta bënte lis, e prozhmin zabel. Në të vetin nuk lënte gjethe të bien përtokë, ndërsa në të fshatit prente më të dy tehat.... sillte si në të huajen.

U hap fjala se "Fondi i tokës" ishte në rrezik; po dëmtohej edhe mali. U mbajtën mbledhje e stërmbledhje. "Njëri thumbit e tjetri patkoit", por rrafshit kurrsesi.

- Dhitë e kanë fajin. - tha rojtari.

- Sikur të ishin vetëm "dhitë" lehtë do të pengohej epidemia. - thanë ata të hyqmetit.

- Dhitë e vetëm dhitë...

Mallkimi jehoi.. Ra VENDIMI, si bie rrufeja. "Dhitë kuqloshë" të qiten fare!

Rojtarit iu shafitën brengat. Tashmë i rriten edhe thonjt. U rrek pas druvarëve, si bleta për polen, ashtu shteg më shteg, si pas dhive: ta kryente detyrën e të mbetet mik, se "lisi përpiqet për lis e njeriu për njeri"...

Kah muzgu zënte shtigjet nën fshat, e nëpër ferk të sabahit qafë malit. Kapërdisej stomit, si kapadainjt ballë oxhaku. I kishte hije edhe kapela shtrembëruar si brirët e sqapit mbi zylyfet e rrumbcallura e sytë çakërr. Kravata i vizullonte si bishti i ngjalës nga yndyra e darkave të majme. Pak i dallohej nga jaka e këmishës së mbylltë që u ka hije "punëtorëve të terrenit". Rrobotet e bukura, si gjethet e vjeshtës ta joshnin uniformën e mbrojtjes kundërajrore, mbase edhe pushkën, me salltanet cubnije e mbante në krahun e majtë, me grykë përpara, jo si në shërbim, por siç e bartin bashibuzukët.

Zullumi mëtrashej e gjurmët e kokrruara treteshin në pluhurin e xhades. Duhej t'ia skuqte dikujt që të dukej se nuk flente Rojtari, i cili hasi në Martinin e përpjekshëm dhe hujnik, nëse e prek në tel...

- Ndalou! - iu ngërdhur Rojtari.

- A nuk të ecet? Afrou, në paç dert të madh. - iu përshtat Martini dhe, vazhdoi: mos më vono, se kam punë...
- As unë nuk dola këtu pahiri! E di kush sillet këndeje, ku i ke mëshehur drutë?!
- Të hollë i paske telat e haberit! Edhe pa rend po ta bluajka.
- Tregomi drutë, ose të padita! Ke pre pa leje, e ngushtoi Rojtari.
- Nuk shtërngohen fëlqijtë, si darët në dorë të padhimshme! A je ti ai i përditshmi?!
- Ti edhe po më kërcënohesh!? Ashtu vetëm dëmton vetën. Mbase mua kështu edhe ashtu rroga më vjen në fund të muajit...
- E, unë... as kështu, as ashtu... dorë mbi krye nuk po qes... shtëpinë e kam prej thuprash - gardh hesapi. Gjel as pulë nuk kam lënë të më këndoje. Një dhi e dy dele i kam për qumësht të carrokëve. Me këtë bisht sakice në dorë rrugës trup i bie pa frikë, pa pendesë.
- Por, rruga e shkurtër shpesh del e gjatë, thonë të moçmit. - përkujtoi Rojtari.
- Vetëm për ata që nuk ia dinë shtigjet, them unë! - ia mëtrusi Martini.
- Shtigjet i ke mësuar duke prerë dru, por më trego ku i ke fshehur? Tjetër rrugë nuk ke!
- Nuk është e drejtë t'i mbyllen njeriut të gjitha dyerët!
- E drejta ime është të m'i tregosh drutë...
- Mirë, de! Për dru... kurrë nuk kemi hjek keq. Por, t'ia japim njëherë këtij stomi! Ta pështjellim nga një cigare, me atë gazetë virane që e çon tymin rrotulla - rrotulla, si oxhaku i Fabrikës së tullave.
- Pa pak rrotulla s'shtyhet dita. - miratoi Rojtari.
- He, të lumtë goja! Një herë ishte ngushtuar njëri dhe, shkoi te fqiu të kërkonte litar, por u dëshprua kur i tha se nuk e kishte zgjidhur prej samarit, e gomari kulloste ashtu i shaluar...
- Lee, se e bëre bërlllok! Asnjë fjalë tjetër! Bëni gati treqint banka... se do të padis! Kisha mund edhe ndryshe...
- Domethënë, ti arrën e gurin-a?! Atëherë, mos më padit, bile mos të mundohem duke bredhur kot. Një herë më thërrasin, mandej më pyesisn. Tjetër herë hetojnë. Më thërrasin përsëri e kërkojnë dëshmitarë. Herën tjetër ti nuk vjen. Më thërrasin e më japin afat të kujtohem. Prapë më thërrasin. M'i prejnë teshat

më të shtrejta se lëkura. Mandej "mule" të paguaj... "sot nuk punojmë", jo u bë vonë! Nesër gjithashtu nuk punohet mbas orarit. Tjetër herë dhe, tjetër herë të tjetër heresh e tjera e tjera. E, opingat të shtjerrura, këmbët e ndrydhura. Gruaja vetëm e djali duke qarë... e, miku im më i miri i fshatit me ba be kështu!? Merri ti... më mirë... të shkojmë secili në rrugë të vet dhe, pa therrë në këmbë!?

- Therrat tua janë të holla për thundrat e mia! Por, mos e qit menç se s'të thërrasin në "kundërvajtje"...

Nuk vonoi shumë, si punët që përfillen, i erdhi Thirrja nga gjykatësi për kundravajtje, i cili e denoi mu me "treqint banka" si e kishte paraparë Rojtari që e dinte ligjin përmendëshs.

Në kthim, për në shtëpi, ia qiti pergjelin: drutë i preu në mal të fshatit, nga inati i Rojtarit, tepricën e ruajti si kursim që e kalonte kryet e gjësë, si haku në hak e rrahu në mal të shtetit. U kujtua pakëz, rراسi kësulën deri te veshët dhe, "pështypu duarët" për më tutje.

Ndërkaq, Rojtari në mënyrë cinike ia hapi grykën çantës, si të përfillte ligjin. Nxori fletorën e shënimeve - Ditarin e të zezave, me bukurshkrimin e tij, si këmbë mize qëndisi emrin e mikut "Martin Kryeneçi". Shënoi edhe një sukses të pandërgjegjshëm në përdhosjen e detyrës së besuar..

Martini, nga ana tjetër, përpiqej t'i përballojë hallet, të mbushet mend. Në ajamin e mëngjesit mprehte sopatën, duke u bishtëruar syve të Rojtarit - zgjëronte shtegun.

E shoqja e Martinit, prapa derës së mbyllur, "me krye në dorë" përgëdhelte voglushin: "Pa i larë sytë nuk më ka zënë dielli; me ty në shpinë kam shkuar në arë, tepsinë mbi krye e bucelën në dorë... Kam përbi edhe fjalë të rënda e zemra ime është bë guri. Dy ditë të bardha s'i kam parë as dy lugë të njoma s'i kam pasur. Por, vetë as shtëpia ime nuk jemi turpëruar".

- Nënë, jepma një copë bukë, një kore...

- Qe... merre!

- Me çka ta njomi?

- Uh! lum nëna... sheqerin e ke nën gjuhë. Nesër e njomim më mirë...

Shkrumi i skamjes, qëndrimi burror i nënës zemërplatur; shikimi dhe fjala e saj: "nesër e njomim më mirë" për veshin e voglushit ishin si fishkllimë ere që depërton përvazëve të plasaritura në derën e pathyer. Këthjelltësia e mirësisë së tij ende nuk ishte ngarkuar me brengat e sëmës, e cila në tërë rininë e saj nuk pati "sote" që t'ia qitte ndërshej nesrës dhe, mos t'i dridhej zemra për kafshatën e sigurtë, për kobin që i sillej rreth kreje. Por fliste me voglushin, si e gjunjzuar para ikonës së shejtit... brenda katër

mureve të asaj kasolle gjysmë guri, gjysmë thuprash të thurrura gërshetë... Fliste me gojën memece, se veshi i voglushit nuk nalte asgjë për veti. Syri i tij nuk i vërente lotët e zemrës, vrragët e jetës, brengat e sëmës.

E ajo kundronte: Kur t'i rritesh nënës "si Rojtari" tanë meshkujt të çohen në këmbë e katundi dridhet prej teje; kah të kalosh frangjitë mbushen sy: Çikat me të pa, nuset thejnë dyerët e plakat kukasin! Çka vyen katundi me një sykan!?

* * *

Martini kalonte shtigjeve, nëpër të cilat më pak bie dielli... drutë e hijes nuk kallen mirë, por thejnë acarin në ditë të ngushtë. në fytyrën e tij nënqeshte skamja që gërrvishte zgurin e lisit të brejtur nga dhëmbi i kohës. E Martini, të cilit një për një s'pati djalë t'ia qitte shpinën përtokë, me nëkëmbëz, as përtarrxuanas; s'e qaste kohën, as zjarrin që ecën... kur i nevojiteshin paratë shiste dru pa leje; nëse sëmuhej shpenzimet e mjekimit i paguante Bashkia. Kur tuboheshin fshatarët nuk gjindej atypari.

- Ka shkua ndër miq - kush dreqi e di kur kthehet!?

- Unori s'e ha brincën...

Nuk ngacmonte, por ishte i rëndë në kthim të hakut. Njeri me qafë aq të shkurtër e me duar aq të gjata rrallë është parë shoqi i tij - nuk dorëzohej. Mirëpo, një ditë prej ditësh e pau Muratin, disi sikur t'ua jepte këmbëve!? E pyeti:

- Murat! A je ti?!

- Po, kush dreqi tjetër! Mos qenke përgjumshëm, Martin-o?

- Jo, jo! Vetëm...

Martini nuk e çoi më gjatë. E kaploi njëfarë çudie. Dyshimi e përshkoi si të rrëqethura të ftohta. Pyeti:

- Ku je nis?!

- Sakt nuk e di. Por, ata që nisen kanë shpresë se mbërrijnë diku... ndërsa hutaçët e humbin rrugën. Por

eja me mua, edhe për ty është rendi.

- Çfarë rendi, more!? Kujt i kam dalur prej hatrit që të më qitite në brazë?!

- Lee ti... atë mesele! Më mirë eja për fllad... se shteg që e pres zhegun nuk kam. - i tha Murati duke ndërruar hapin.

- As vetë s'kam shteg që nisem... edhe kështu "pa veshë në krah" nuk dal te dera e Oborrit... ani më me Kaçubet mbi krye!? Edhe kur zdirgjem të shes dru nuk i bie midisit. I shes pakëz më lirë, veç shpejt i heq doret. Por, pse po shkon sot në pazar? Asgjë s'paske për të shitur!?

- Jo, bre! Deshta "m'u slika për legitimaci"...

- Uh, nxirre edhe një për mua...

- He! Taravol...

- Çka! Taravol...

- Çka! A s'i ngjanë njeriut njeriut?

- Por, s'e kemi të gjithë një surrat. Fotografia i ka rrudhat e imta. Duhet fotografuar secili për veti. Ndryshje "nuk e hanë bajlozat e hyqymetit. Më para kryet në bahe, se fytyrën plaf..."

- Ndiqe si ia ke nisur, se unë midis malit nuk po fshehem dot, e ti pasqyrohesh para syretxhive!? Animë edhe syretin m'ua lënë peng! Çka bëhet me leje nuk shkelë jashtë megjje. Jam lag unë edhe tërë pa strehë, pa diell. Sakicës ia kam shkurtuar bishtin që t'më bëhet më doracake. Nëse mundesh bënma këtë të mirë, mbase këto herë nuk mendoj t'i bie rrafshit - të dalë ku të dalë!

2.

Bungaja si dushkajë e kërleshtë nuk premtonte ajamin për gjah. Përkundrazi joshte huqet e Rojtarit, i cili shquante Martinin ndër kryeneçët që do t'i zbuste praktikisht, pa qasur përfilljen, pa ia ndarë gazepin "opingës" që s'e hante kurrfarë lime... As klima nuk i përshtatej vjeljes pa rend. Aty gjallërohej veresi, e puna quhej angarie... Shpatin mbi terthoret gjelbëroshe e hijeshonin tjegullat e kuqe të pullazeve pa Çardak. Ziliçarit do t'i dukej sikur fabrika të ishte fajtores për ndërrimin e rrasave që rëndojnë pullazin e lëndëve të holla. Parcelat djerrorë, si lehtë të qëndisura në pronat e imta mezi

prodhonin kafshatën e carrokëve të cullakosur, kurse ato "shoqëroret" përthekoheshin në humbjet e grumbulluara, si në rabush: ca nga parazitët, aq edhe nga rrinçat e ngjitura në lëkurën e terur, si në tavan... Varfanjakët i rrëzbit skamja - mungesa e almiseve; papunësia që tferrin bereqetin.

Aty kullandriste Veçili i Kryezotit të mallit e të shpirtit... prodhuesit mbërtheheshin si në rripin me një vrimë.

Fshati errej në terr - muzgu ia merrte anën agut që gëdhihej pa vesë, pa diell. E mbivadja nuk prodhonte as kafshatën e thatë. Ndryshimet emertoheshin me emra të ri e zhagiteshin në mënyrë të vjetruar. Kooperativa bujqësore - fshatare ishte shndërruar në bakallhane, pa treg, pa prodhim kurrfare. Më shtrejt i kushtonte bujkut fara, plehu e vada, se tërë bereqeti që rrumbullakos korrija e re. Prodhuesi individual duhet t'i mbajë "shtatë mëzorë" për një thes pleh, të prodhojë dy okë misër për një kilogramë krunde të grunjta...

Martinin s'e joshte kazani i Bashkisë. Mbase pushtetmbajtësit, për varfanjakët i shtinin veshët në lesh. Lutjet dhe ankesat dergjen si kungujt që lëshojnë lozë ashtu kacavjerrur si në gardh të Oborrit. Ndërsa gajlet i ishin besuar Rojtarit, pa vulën e të cilit tashmë, as "dëmtuesit e malit" nuk e shohin diellin...

Një ditë prej ditësh, njëri që zhdredhte telat e ndryshkur hasi në tjetrin që fajsonte shtyllat e largpërçuesit, kurse Rojtari pa përvojë përgjonte Martinin natën e flente ditën për diell. Nuk i bëhej vonë që të ndërthurrte leqet e kullandrisjes, mbase dielli shkrinë brymën e zbut qehren e zyrtë. E ngricat presin dimërin. Rojtari rradhiste në Blokun e shënimeve emrat e "kryeneçëve" të fshatit dhe njëfarë suksesi që quhej vigjilencë e ndërgjegjes së prishtë. Nënçmonte gjithçka që mund të trajtohej dhunshëm: ç'prej majes së malit, në lugje të gjuetisë, deri në breg të detit.

Edhe Martinin gjithë i rrinin të hapura Dyerët e Oborrit krah e m'krah, mbase çelësat e shtëpisë i mbante në xhep, e torbën hazne ushqimi. Rrathët e shtrëngesave nuk i vënte në fre, por mali gjelbërosh i bëhej shtrojerë. Shtonte hisen, si të kishte lindur në "Natë të Madhe" dhe përforconte besimin e ndërsjellë. Edhe pse Rojtari nuk i thirrte sendet në emër, veç trillon diç, si "Koll i Mirë" që përballohet keqas, Martini bën zemrën gurë: N'u bëftë deti kos kërkon lugë...

- Për çka është pushteti!?

- Mbase i plotfuqishmi han me rabush e kullandris pa fre...

Në hopet e Periudhës Kalimtare pse mos të veçohej Rojtari - zoti i pyllit - mik me gjarpërin që helmon e mësheh këmbët dhe thonë: ik se të kafshon"! Andaj secili që ka diç në dorë zë ndonjë qoshe kyçe dhe

shtyhet për të rrokur dizgjinat që të shuk copë më të madhe nga shteti që i lanë mëkatet me lëkurë. Rojtari i këndon rahmet periudhës, në të cilën pushteti lokal qeveris me aq zemërgjerësi, mbase edhe fshatarët do t'i dhuronin truall falas, me shpresë se do t'i bëhej varr i paharrueshëm.

Bashkësitë lokale, si shumicë do t'ua merrnin për gryke komunave edhe pse nuk ndiheshin gjallë "nga më lartë". Megjithatë hyqymeti që "zë lepurin me kerr" ua lën Planin në qafë plangjinjve - kontrollin e mbanë për veti, punën e përpjeston në atë fizike e mendore, ndoshta që mos të meremetohej asnjëra... Edhe rojtari flente nga gjysma e ditës deri në gjysmë të natës, meqë në të katër hiset e ditës vetëm një të katërtën e ka të shitur, për "rrogën e gazezit". Hiset tjera hyjnë në kusuritje: diku bashkë, diku- diku vetëm, si diç që mund të rrumbullaksohej si vilë rrushi nga vreshta, të cilën e ruan frika.

Nën pullazin e Bashkësive Pyjore kullandris Kryengjeshuri që ruan pyjet e dreqi han fushën dhe shpirtin me gjithë bereqet... Mbase, sipas gjasave edhe pyjet i takojnë "Fondit të tokës" së premtuar...

Tashmë, trapazani nuk qas çka pik nga Kryeoda, por nxirr trima të urtë dhe të vyeshëm, në të cilët mund të mbështetet Oda e Burrave, trualli i babait dhe mëmëdheu arbëror.

3.

Atëbotë Komunën e kishin kapluar hallet, ekonomia e fikur e rojet të dalura doret. Polaku do të kujdesej për pyjet që i rrallonte sakica bishtcubele, kurse "bota arnautë" zhveshej sikur të ishte pronë e dreqit të mallkuar. Tashmë edhe Rojtari i ri "mos i qoftë për kob" kishte zënë punë, mu kur të papunët vargoheshin të panumruar para të ashtuquajturës "Byroja për inkuadrim"...

Salltaneti ua kalonte zburimeve që u ka hije Portave Triumfale. Nën harkun e tyre vrapojnë të vyeshëm e të papunë - përtacë e parazitë që ecin pa drojën e mortajës, pa kuptuar pse të shqetësuarit i kapte njëfarë nëpërbarke, e hutaçët binin si "zorra në prush".

Koha bën të vetën. Por, ndryshimi i motit, kësi shtegu i ngjante ndërrimit të samarit. Mbase Rojtari përgëzon Bashkësinë e Pyjeve, duke përfillur shtrirjen e lozëve në "Fondin e Tokës" që shtohet, si "pronë shoqërore". Qeveria i kushton kujdes të posaçëm ruajtjes së pyjeve dhe zhdukjes së "dëmtuesve të papërshtatshëm" në regjione të caktuara me Dekret. Zullumi ua merrte anën mundësive, pa bërë hesap se drejtësia nuk e ka me të mujshëm. Njëpërmjet të rojeve i grahnin më të vetën. Por, praktika zbulon hilen që do të thotë: "Kungulli nuk shkon gjithmonë mbi ujë".

Martini njih shtetin si Qeveri pushtetmbajtëse - shtypëse sall keqëbërëse, me ofiçarë e bashibuzukë që keqpërdornin shërbimin, njeriun dhe shtetin. Friksojnë të nënshtruarët, të cilët më parë përshëndesin xhandarin e mëvrëjtur, se Kryetarin buzëqeshur dhe, me plot gojën thonë: "Shnukja thiut një qime"!

Edhe Rojtari zënte stomin, e shplodhte këmbët që mos të zhagitej nëpër pyll. Mos t'i shqepeshin pantallonat, as pullat vizilluese të uniformës, në të cilën mbështillej dordaleci i kobshëm. Megjithatë do të shquhej edhe për dinakrinë e rafinuar. Besonte se qëllimi i synuar nuk do të zhgënjejë aq dëshprueshëm...

Sllavoja, në këtë ajam nxirrte një "teste ligjesh, pa ua shkelur këmbën mëdyshjeve. Gjithë lën diç që t'i gjindej si përgjegje mahnitëse, mbase lindnin kopilat si në bungajë të thive. Mosmarrëveshjet mohojnë ekzistencën "e dhive" e shquajnë aftësitë e rojtarit - sqapit që ruan lakrat...

- Kësi vjeti do të kemi bereqete të bollshme. - përgëdheli Rojtari, jo aq bindshëm, si në Kuvend.

- Çka mbiell korrë thonë këndeje kah na. - ngacmoi Martini që nuk ia varte torbën.

- Rendi është të hiqen dhitë që t'i ndalet zullumi malit. - përsëriti Rojtari.

- Po, veç thuajm kush e kurdisi atëfarë rendi!?!... dëgjohet vetëm gurgullima e ibrikut të kafes që vlon pranë urëzave.

- A është me hatër, a me zort?!

- Me hatër... dhe, sipas rendit në fuqi...

- Eh, aq i duhet Martinit! Ne tekajytët përbijmë edhe hanxharë.

Elita sunduese predikon hir... e fshati merr frymë, si ndërmjet zapullimës kundërmuese e dhunës së përmortshme. "Kryeneçi" i marrur në thumb mund ta zënte qafën në terthoret e malit. Por, Rojtari shkyente shpatulla pule shtyrë me verë shumëvjeçare. Ndërsa Martini rrëshqiste në sajat që i mbaronte nga drurët e vjedhura dhe, shiste salltanet me skijat pa frerë.

Dimrit i gëzoheshin njësoj: rojet e pyllit, si dhe shërbimet e punëve komunale dhe të komunikacionit. Mbase kundërvajtjet lidhen të thurrura gogisht. Dëbora e bardhë mbulonte bërllokun e zi, kurse akullin e shkrin me zhavor, në vend të kripës dhe, shpenzonin buxhetin fiktiv, siç parashihej me Plan të miratuar. Gëzohet edhe Rojtari, se tashmë mund të gjuante ndonjë dhelpër fatzezë për lëkurën e saj të çmueshme.

Përkundër tronditjeve të zymta dhe, ndarjes pa përshëndetje, Martini ëndrronte të gjejë punë jashtë

vendit, por njëra këmbë e lëshoi mu në pragun e larë me lot, e tjetra i dukej si e kacavjerrur në gardh të oborrit... a thua do ta lëshonte shpirti në mërgim, ose të mbahej gjallë për gazepi që mos ta kishte mall pragun, vekun e nënës; drugëzen e motres dhe, hallallin e vëllaut...

Shkasi bëhej i përfushtë, por rrjedhimet merrnin krye kah thellësitë, ku mëtrashej zullumi, e kush kujt nuk i dilte zot. Ndërmjetësit vlonin si në zgjua të bletës, e duarët i kishin me dorëza - sytë pa perde, ashtu si i plasin sytë marramenthit.

Edhe gjeneza e papunësisë, pa prit e pa kujtua, merr tjetër kahje, por gojëmbyllur, si "çele gurë gojën"... hallet zihen si në tym e skamja përvlon si vala që derdhet në zharavë, pa mallkimin e babait, pa hallallin e nënës. I merguari mallkoi: le të më çojnë këmbët si të donë dhe ku të munden, por kryet të më bie pranë urëzave të oxhakut që tymon - në vatrën time - të kthehem gjallë dhe i pasur. Këtu më është vdekja më e hijshme...

Sikur të ishte në qytet Martini do t'i praptonte të gjitha autoveturat që zënë trotuarin - i nxirr punë edhe hyqymetit!

Ëndroja se gjerësitë dhe largësitë e majeve të pashkelura frymëzojnë forcat lëvizëse të gjenin zgjidhje të përhershme, pa fajsuar fabrikën, pse nuk u zën majë fijeve të shkrepsës me më shumë squfër që të ndizen me të parën! Ndërkaq as varfanjakëve nuk u merrte kryet vesh: lënë tokën ledinë, bredhin rrugëve të qytetit, e zgjatet kolona e të papunëve, delikuentëve të ndryshëm dhe, lypsave të gjorë. Pezmatohen huqet e sakicës dhe, "sëmundja e qenit"...

Varfanjakët bëjnë plafin hebe dhe marrin dheun në sy: kundër dhunës dhe, mos të dergjeshin në skamje. Por, bota e jashtme nuk thith të ëmën, veç lulën e jetës, pa u bërë rrah, pa paguar haraç, si haku në hak e rrahu në mal të shtetit...

Edhe Martini, si ndërmjet peripetive të fshatarit dhe punëtorit urban, këmbas u rrit që këmbadoras ia luajti gurët Rojtarit dhe, preu dru si në krye të gjarpërit: ia solli gazepin atij dhe hyqymetit që çeli rabushin dhe, përmendi çfarosjen e dhive... Me Planin Hapsinor zgjëroi harkun e ledinave, kullosave dhe bjeshkëve...

...Nënvizoi përvehtësimin e trojeve të bimëve mjekësore dhe shtrojerat e shpendëve të rrallë, veçmas të shqiponjave; rrethekon pellgjet e gjuetisë, sidomos të peshkimit, të derrave e të dhive të egra, të kaprojeve e të arushave; rudina e male - majet e larta me lumenj currilash të kristaltë, e pozitën strategjike të natyrës së pashkelur. Mbase edhe Rojtari "rrëfëhet": nëse paskëm shikuar çakërr - nuk do të thotë se bëra faj...

- Martin-o! shtetin mos e zë në gojë, se të mbërthen lemza... del diçka, si "mos e prek në bisht, se të kafshon në gisht"!

- As për Bilanc Përfundimtar nuk mund të bëhet fjalë, mbase të hyrat derdhen si në pus të pafund e të dalat i han dreqi, sepse çmimi i fabrikuar përshkon mbivlerat kallpe. Kostoja e jetës ia kalon shumëfish bazës materiale të shoqërisë që shpenzon pa gajlen e milingonave, të dilat shkelen mizorisht... Por, mbi të gjitha shtohen si fara e hithave...

- Kuvendi akordoi qëndrimet orientuese - VENDIMI për zhdukjen e dhive shtriu flatrat e miratimit - "dhitë kuqloshe" iu nënshtruan shuarjes së dhunshme...

Rojtari u pendua, e Martinit iu topit sakica... i pari u transferua në një "FIDANISHTË" të rrethuar me shimshirë, në vend të gardhit me tela të thepisur, kurse i dyti kërkonte dëshmitarë për Letërnjofim.

P Ë R M B A J T J A

I. MOS MË PREK NË STRAJCË TË FUKARASË, 5

II. FANTAZMA, 20

III. ZJARRI QË ECËN, 32

IV. TËRTHORAZI, 42

1. Në agun e lirisë, 45

2. Trokitje e trok, 46

3. Pa kohë, vend e emër, 48

4. Fatkeqësi intime, 52

5. Krrabëz për vegëza, 55

6. Ngushllim, 61

7. Nënfletë gjuhësh të nëpërbojura, 64

V. HAKU NË HAK, RRAHU NË MAL TË SHTETIT, 66